

MANUALI PËR PUNËN E KËSHILLAVE TË VENDVOTIMEVE

1. KOMPETENCA DHE PËRBËRJA E ORGANEVE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

1.1. ZGJEDHJET PËR DEPUTETËT POPULLORË TË KUVENDIT POPULLOR DHE ZGJEDHJET PËR PRESIDENT TË REPUBLIKËS

Ligji për zgjedhjen e deputetëve popullorë dhe Ligji për zgjedhjen e presidentit të Republikës si organe për zbatimin e zgjedhjeve për deputetët popullorë, përkatësisht zgjedhjet për president të Republikës (në tekstin e mëtejme: zgjedhjet parlamentare) kanë përkufizuar:

1. **Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)**
2. **Komisionet Komunale Zgjedhore**
3. **Këshillat e vendotimeve**

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KQZ është kompetent dhe duhet të kujdeset për zbatimin e ligjshëm të zgjedhjeve në përputhje me ligjin.

KQZ ka përbërjen e përhershme dhe të zgjeruar.

Përbërja e përhershme e KQZ-së e cila zbaton zgjedhjet parlamentare të shpallura për datën 3 prill të vitit 2022, është zgjeruar, në përputhje me ligjet zgjedhore, me gjashtë anëtarë të tjerë dhe gjashtë zëvendësanëtarë, të cilët janë propozuar nga kryetari i Kuvendit Popullor, kështu që përbërja e përhershme e KQZ-së aktualisht përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari, 22 anëtarë dhe 22 zëvendësanëtarë, sekretari, zëvendëseekretari i KQZ-së, si edhe dy pjesëmarrës të ngarkuar për punët e statistikës.

Gjatë zgjedhjeve parlamentare, të cilat do të mbahen më 3 prill 2022 KQZ punon në një **përbërje të zgjeruar** e cila, sipas Ligjit, përbëhet nga përbërja e përhershme dhe anëtarët dhe zëvendësanëtarët e emëruar me propozim të paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore të kandidatëve për deputetët popullorë dhe propozuesit të kandidatëve të shpallur për president të Republikës.

KOMISIONI KOMUNAL ZGJEDHOR

Komisionet Komunale Zgjedhore nga pikëpamja e Ligjit për zgjedhjen e deputetëve popullorë janë:

- komisionet komunale zgjedhore
- komisionet zgjedhore të qyteteve
- Komisionet zgjedhore të komunave të Qytetit të Beogradit

Komisionet Komunale Zgjedhore kryejnë punët të cilat në zgjedhjet e mëparshme ishin ushtruar kryesisht nga organet punuese të cilat i ka formuar Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për nevojat e zbatimit të zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale.

Sipas Ligjit të ri mbi zgjedhjet lokale, numri i anëtarëve të përbërjes së përhershme të komisionit komunal zgjedhor varet nga madhësia e njësisë së vetëqeverisjes lokale për të cilën emërohen, dhe kështu komisioni komunal zgjedhor në përbërjen e përhershme përbëhet nga:

- kryetari, gjashtë anëtarë, zëvendëskryetari dhe gjashtë zëvendësanëtarë në njësinë e vetëqeverisjes lokale e cila nuk ka më shumë se 50.000 votues të regjistruar
- kryetari, tetë anëtarë, zëvendëskryetari dhe tetë zëvendësanëtarë në njësinë e vetëqeverisjes lokale e cila nuk ka më shumë se 100.000 votues të regjistruar
- kryetari, dhjetë anëtarë, zëvendëskryetari dhe dhjetë zëvendësanëtarë në njësinë e vetëqeverisjes lokale e cila nuk ka më shumë se 500.000 votues të regjistruar
- kryetar, 12 anëtarë, zëvendëskryetari dhe 12 zëvendësanëtarë në njësinë e vetëqeverisjes lokale e cila ka më shumë se 500.000 votues të regjistruar

Përbërja e përhershme e komisioneve komunale zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të shpallura për datën 3 prill të vitit 2022 është zgjeruar, në përputhje me ligjet zgjedhore, me edhe një anëtar dhe zëvendësanëtar, të emëruar nga KQZ-ja me propozim të kryetarit të Kuvendit Popullor.

Gjatë zgjedhjeve, komisionet komunale zgjedhore punojnë në përbërje të zgjeruar e cila, sipas Ligjit, si edhe KQZ, përbëhet nga përbërja e përhershme dhe anëtarët dhe zëvendësanëtarët e emëruar me propozim të paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore të kandidatëve për deputetët popullorë dhe propozuesit të kandidatëve të shpallur për president të Republikës.

Detyrat e komisionit komunal zgjedhor në zbatimin e zgjedhjeve parlamentare janë që të:

- organizojë përgatitjen teknike të zgjedhjeve
- emërojë, shkarkojë dhe konstatojë ndërprerjen e funksionit të anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të organeve për zbatimin e zgjedhjeve
- përcaktojë vendvotimet
- vendosë rreth kërkesave për anulimin e votimit në një vendvotim për shkak të parregullsive gjatë zbatimit të votimit
- pranojë materialin zgjedhor nga KQZ-ja dhe ua dorëzon këshillave të vendvotimeve
- marrë materialin zgjedhor nga këshillat e vendvotimeve pas përfundimit të votimit
- t'u japë mbështetje këshillave të vendvotimeve gjatë zbatimit të votimit
- njoftojë KQZ-në për procesin e votimit
- krijojë raportin përmbledhës për rezultatet e votimit nga vendvotimet të cilat gjenden në territorin e tij.
- kryejë punët e tjera në përputhje me Ligjin për zgjedhjen e deputetëve popullorë dhe aktet e KQZ-së.

KËSHILLAT E VENDVOTIMEVE

KËSHILLAT E VENDVOTIMEVE:

- marrin materialin zgjedhor nga komisioni komunal zgjedhor para votimit
- përgatisin vendvotimin për fillimin e votimit dhe rregullojnë vendvotimin dhe ambientin e votimit
- zbatojnë votimin në vendvotim
- zbatojnë votimin jashtë vendvotimit
- sigurojnë rregullsinë dhe fshehtësinë e votimit
- mbajnë rend në vendvotim
- përcaktojnë rezultatet e votimit në vendvotim
- pas votimit i dorëzojnë materialin zgjedhor komisionit komunal zgjedhor

Këshillat e vendvotimeve kanë përbërjen e vet të përhershme dhe të zgjeruar.

Përbërjen e përhershme të këshillit së vendvotimit e emëron komisioni komunal zgjedhor me propozim të grupeve të deputetëve, dhe e përbëjnë kryetari, dy anëtarë dhe zëvendësit e tyre.

Përbërja e përhershme e këshillave të vendvotimeve e cila do të zbatojë zgjedhjet parlamentare më 3 prill 2022 është zgjeruar, në përputhje me Ligjin për zgjedhjen e deputetëve popullorë, me edhe një anëtar dhe zëvendësanëtar të cilët emërohen nga KQZ-ja me propozim të kryetarit të Kuvendit Popullor.

Këshilli i vendvotimit në përbërje të zgjeruar është përbërë nga përbërja e përhershme dhe anëtarët dhe zëvendësanëtarët e emëruar me propozim të paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore dhe të propozuesit të kandidatëve të shpallur për president të Republikës.

Pamja grafike e organeve për zbatimin e zgjedhjeve për deputetët popullorë dhe zgjedhjeve për president të Republikës të cilat do të mbahen më 3 prill i vitit 2022 në përbërje të zgjeruar

Pamja piramidale e organeve për zbatimin e zgjedhjeve



1.2. ZGJEDHJET PËR KËSHILLTARËT E KUVENDEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE

Më 3 prill në 14 qytete dhe komuna, duke përfshirë dhe komunën e Sevojnos në qytetin e Uzhicës, së bashku me zgjedhjet parlamentare do të mbahen edhe zgjedhjet për këshilltarët e kuvendeve komunale (zgjedhjet lokale).

Me Ligjin për zgjedhjet lokale si organe për zbatimin e zgjedhjeve lokale janë përkufizuar:

1. Komisionet zgjedhore të njësisë së vetëqeverisjes lokale (KZ)
2. Këshillat e vendvotimeve

PËRBËRJA E ZGJERUAR E KOMISIONEVE ZGJEDHORE DHE KËSHILLAVE TË VENDVOTIMEVE

Në komunat/qytetet ku më 3 prill do të mbahen zgjedhjet lokale, përbërja e zgjeruar e komisioneve komunale zgjedhore dhe këshillave të vendvotimeve do të përbëhen edhe nga anëtarët dhe zëvendësanëtarët e emëruar me propozim të paraqitësve të listave të shpallura zgjedhore për zgjedhjen e këshilltarëve të kuvendeve të komunave/qyteteve, me kusht që të mos marrin pjesë njëkohësisht edhe në zgjedhjet parlamentare.

1.3. KODI I SJELLJES SË ANËTARËVE DHE ZËVENDËSANËTARËVE TË ORGANEVE PËR ZBATIMIN E ZGJEDHJEVE

Me qëllim të përparimit të punës, por edhe të vendosjes së standardeve etike të sjelljes të cilat priten nga organet për zbatimin e zgjedhjeve, KQZ ka miratuar Kodin e sjelljes së anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të organeve për zbatimin e zgjedhjeve.

Në përputhje me Kodin, anëtarët dhe zëvendësanëtarët e organeve për zbatimin e zgjedhjeve kanë për detyrë:

- të ushtrojnë detyrat e besuara në mënyrë të ndërgjegjshme dhe profesionale në kuadër të autorizimeve të dhëna
- të kryejnë punët në mënyrë të paanshme dhe efikase, në përputhje me standardet profesionale
- t'i përmbahen parimit të neutralitetit politik gjatë kryerjes së funksionit
- të kujdesen për interesin publik gjatë vendimmarrjes, përkatësisht që interesi i tyre privat të mos vijë në konflikt me interesin publik
- të veprojnë në kuadër të autorizimit të dhënë dhe në përputhje me qëllimin për të cilin është dhënë autorizimi
- të sillen në mënyrë të durueshme, me edukatë, mirësjellje dhe me të gjithë kujdesin dhe respektin ndaj të gjithë votuesve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurën zgjedhore, dhe sidomos ndaj personave me aftësi të kufizuara
- të vishen në mënyrë të përshtatshme dhe pastër dhe të mos dëmtojnë me mënyrën e tyre të veshjes reputacionin e organeve për zbatimin e zgjedhjeve;
- të jenë të përditësuar, profesionalë dhe të saktë në përmbushjen e detyrimeve ligjore
- të zhvillojnë marrëdhëniet kolegiale dhe korrekte ndaj anëtarëve të tjerë dhe zëvendësanëtarëve të organeve për zbatimin e zgjedhjeve
- të ruajnë reputacionin e organit të cilin e përfaqësojnë

Anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të organeve për zbatimin e zgjedhjeve nuk u lejohej:

- të marrin një dhuratë, shërbim ose ndonjë përfitim tjetër për veten ose anëtarët e familjes së tyre gjatë kryerjes së funksionit, me përjashtim të një dhurate protokollare ose përkatëse deri në vlerën e përcaktuar në ligj
- të përdorin pronën publike dhe ambientet zyrtare të organeve për zbatimin e zgjedhjeve për qëllime private ose politike, as të keqpërdorin funksionin e tyre me qëllim të përfitimit personal ose përfitimit të partisë politike e cila i ka propozuar në përbërjen e organeve për zbatimin e zgjedhjeve
- të favorizojnë ose diskriminojnë votuesit e caktuar në realizimin e të drejtave të tyre zgjedhore në bazë të përkatësisë politike, kombëtare, racore, fetare, gjinore ose tjetër
- të japin deklaratat e pavërteta ose informacionet të cilat mund të dëmtojnë reputacionin e organeve për zbatimin e zgjedhjeve ose të vënë në pyetje integritetin e procedurës zgjedhore
- t'u bëjnë me ose pa qëllim dëmin material organeve për zbatimin e zgjedhjeve ose të nxisin personat e tjera për këtë
- të shprehin publikisht përkatësinë e tyre politike, fetare ose përkatësi tjetër personale e cila mund të vërë në dyshim neutralitetin e tyre në vendimmarrje
- të mbajnë simbolet dhe parullat e partive politike në ambientet zyrtare

2. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR PARA VOTIMIT

KQZ dorëzon materialin zgjedhor të destinuar për zbatimin e zgjedhjeve parlamentare përmes anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të tij, në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar, të cilët autorizohen si koordinuesit e KQZ-së të ushtrojnë disa veprime zgjedhore për komunat në territorin e rrethit administrativ.

Koordinuesit e KQZ-së ua dorëzojnë materialin zgjedhor komisioneve komunale zgjedhore nga territori i rrethit administrativ për të cilin janë të autorizuar, në selitë e rrathëve administrative.

Komisioni komunal zgjedhor ua **dorëzon materialin zgjedhor** këshillave të vendvotimeve nga territori i komunës/qytetit të tyre **në selinë e komunës/qytetit**.

Për kohën, vendin dhe rendin e dorëzimit të materialit zgjedhor të këshillat e vendvotimeve, komisioni komunal zgjedhor njofton kryetarët dhe zëvendëskryetarët e këshillave të vendvotimeve, si dhe personat e autorizuar për propozimin e personave në këshillat e vendvotimeve në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar.

Dorëzimi i materialit të këshillat e vendvotimeve kryhet **jo më vonë se 24 orë para ditës së votimit**, përkatësisht më vonë së ditën e premte, më 1 prill 2022.

Për dorëzimin e materialit zgjedhor midis komisionit komunal zgjedhor dhe këshillit të vendvotimit **përpilohet një procesverbal** i cili përmban listën e të gjitha materialeve të cilat i merr këshilli i vendvotimit nga komisioni komunal zgjedhor.

Për çdo zgjedhje në të cilat do të votohet më 3 prill, dorëzohet materiali i veçantë zgjedhor, dhe për këtë arsye përpilohen procesverbalet e veçanta për dorëzimin e atij materiali për çdo zgjedhje.

SHËNIM:

Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor mund të jenë të pranishëm përfaqësuesit e autorizuar e paraqitësve të listave zgjedhore, përkatësisht propozuesit e kandidatëve për president të Republikës, si edhe përfaqësuesit e vëzhguesve të cilave ua ka lëshuar akreditimet KQZ.

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE DHE KOMISIONI KOMUNAL
ZGJEDHOR PËR ÇDO KËSHILL TË VENDVOTIMIT, PËR ZGJEDHJET
MË 3 PRILL I VITIT 2022 SIGUROJNË:

- **Listën përmbledhëse zgjedhore të kandidatëve për deputetët popullorë dhe Listën e kandidatëve për zgjedhjen e presidentit të Republikës**

(Lista përmbledhëse zgjedhore është një dokument i cili përmban të gjitha listat zgjedhore, me emrat personalë të të gjithë kandidatëve për deputetët popullorë dhe të dhënat mbi moshën e tyre, profesionin dhe vendbanimin, ndërsa Lista e kandidatëve për zgjedhjen e presidentit të Republikës është një dokument i cili përmban emrat dhe mbiemrat e kandidatëve, moshën e tyre, profesionin dhe emrat e propozuesve të tyre.

Këto dokumente shtypen në gjuhën serbe, në alfabetin cirilik. Në komunat/qytetet ku përdoren zyrtarisht gjuhët e pakicave kombëtare këto dokumente do të shtypen në ato gjuhë.

Ligji urdhëron që Lista përmbledhëse zgjedhore dhe Lista e kandidatëve për zgjedhjen e presidentit të Republikës të shpaloset në mënyrë të dukshme në vendvotim gjatë votimit në mënyrë që votuesit, gjatë votimit, të informohet për të gjitha listat zgjedhore dhe të gjithë kandidatët për deputetët popullorë dhe presidentin e Republikës.

- **Vendimin për emërimin e anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit**
- **Vendimin për emërimin e anëtarit dhe zëvendësanëtarit të përbërjes së përhershme të këshillit të vendvotimit, me propozim të kryetarit të Kuvendit popullor.**

(Vendimi përmban emrat personale të personave të emëruar në përbërje të përhershme të këshillit të vendvotimit me propozim të kryetarit të Kuvendit Popullor dhe shërben që të përcaktohen të cilët persona janë të autorizuar si anëtarë të këshillit të vendvotimit që të zbatojnë votimin në vendvotim.)

- **EKSTRAKTIN NGA LISTA E VOTUESVE PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETËVE POPULLORË dhe EKSTRAKTIN NGA LISTA E VOTUESVE PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS,** me listën eventuale të ndryshimeve të mëvonshme në listën e votuesve e cila dorëzohet së bashku me ekstraktin nga lista e votuesve.

(Ekstrakti / ekstrakti i veçantë nga lista e votuesve është një dokument i cili përmban të dhënat personale mbi votuesit të cilët kanë të drejtë të votojnë në një vendvotim dhe shërben edhe për të evidentuar votuesit që kanë votuar.)

- **EKSTRAKTIN E VEÇANTË NGA LISTA E VOTUESVE PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETËVE POPULLORË dhe EKSTRAKTIN E VEÇANTË NGA LISTA E VOTUESVE PËR ZGJEDHJEN E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS**, nëse në vendvotim votojnë votuesit të cilët janë në shërbimin ushtarak, ushtrimin ushtarak ose shkollimin në njësitë ose institucionet e Ushtrisë së Serbisë.

(Ekstrakti i veçantë nga lista e votuesve është një dokument i cili përmban të dhënat personale për votuesit të cilët kanë të drejtë të votojnë në vendvotim dhe shërben edhe për të evidentuar votuesit që kanë votuar.)

- **FLETËVOTIMET për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale për votimin e votuesve SIPAS EKSTRAKTEVE / EKSTRAKTEVE TË VEÇANTA nga lista e votuesve dhe listat eventuale me ndryshimet e mëvonshme në listën e votuesve**

Në komunat/qytetet ku zyrtarisht përdoren gjuhët e pakicave kombëtare, fletëvotimet shtypen në ato gjuhë. Logjikisht, numri më i madh i fletëvotimeve shtypen vetëm në gjuhën serbe dhe alfabetin cirilik, por ekzistojnë madje edhe 28 variante të ndryshme të fletëvotimit (për shembull, serbisht-hungarisht, serbisht-boshnjakisht, serbisht-hungarisht-slllovakisht, etj.). Natyrisht, nga numri i gjuhëve në të cilat shtypet fletëvotim varet edhe formati (madhësia) e fletëvotimit.

- **FLETË KONTROLLUESE** për kontrollimin e rregullsisë së kutisë së votimit **për zgjedhjen e deputetëve popullorë** dhe **FLETË KONTROLLUES** për kontrollimin e rregullsisë së kutisë së votimit për zgjedhjen e presidentit të Republikës.

(Këshilli i vendvotimit kontrollon nëse kutitë e votimit janë të rregullta dhe të zbrazëta. Rezultati i kontroleve shkruhet në fletën përkatëse kontrolluese për zgjedhjet parlamentare, përkatësisht presidenciale.)

- **PROCESVERBALIN PËR PUNËN E KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT** në zbatimin e votimit **për zgjedhjen e deputetëve popullorë** dhe **PROCESVERBALIN PËR PUNËN E KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT** në zbatimin e votimit **për zgjedhjen e presidentit të Republikës, secili në gjashtë kopje**

(Procesverbali për punën e këshillit të vendvotimit është një dokument të cilin e plotëson këshilli i vendvotimit dhe në të cilin shënohen të gjitha faktet rreth procesit të votimit dhe rezultatet e votimit në vendvotim.

(Procesverbali për punën e këshillit të vendvotimit shtypet, përveç gjuhës serbe dhe alfabetit cirilik, edhe në çdo gjuhë dhe alfabet të pakicave kombëtare të cilat janë në përdorim zyrtar në atë njësi të vetëqeverisjes lokale. Kjo do të thotë që në ato komuna në të cilat, së bashku me gjuhën serbe, përdoren zyrtarisht për shembull edhe dy gjuhë të tjera, do të ekzistojnë formularët e tri procesverbaleve për punën e këshillit të vendvotimit në gjashtë kopje, përkatësisht nga një formular për çdo nga tri gjuhë)

- **Formularin e Procesverbalit për vëzhguesit të punës së këshillit të vendvotimit në zbatimin e votimit në zgjedhjet për deputetët popullorë dhe zgjedhjet për president të Republikës, në gjashtë kopje**

(Në Procesverbalin për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit shkruhen të dhënat mbi përfaqësuesit e vëzhguesve vendorë dhe të huaj të cilët ishin të pranishëm në vendvotim. Këta përfaqësues kanë të drejtë që në Procesverbalin t'i shkruajnë vetë ankesat e tyre eventuale, përkatësisht vërejtjet lidhur me zbatimin e votimit në vendvotim.)

- **Manualin për punën e këshillave të vendvotimeve**

(Manuali për punën e këshillave të vendvotimeve është një publikim i cili përmban një sërë rregullash mbi mënyrën e veprimit të këshillave të vendvotimeve gjatë zbatimit të votimit dhe përcaktimit të rezultateve të votimit në vendvotim.)

- **FORMULARIN KONTROLLUES** për renditjen logjiko-llogaritëse të rezultateve të votimit në **zgjedhjet parlamentare** dhe **FORMULARIN KONTROLLUES** për renditjen logjiko-llogaritëse të rezultateve në **zgjedhjet presidenciale**.

(Formulari kontrollues është një mjet i cili duhet ta ndihmojë këshillin e vendvotimit gjatë përcaktimit të rezultateve të votimit dhe kontrollimit të rregullsisë së rezultateve të caktuara.)

- **FLAMURIN SHTETËROR TË REPUBLIKËS SË SERBISË**



(Flamuri shtetëror i Republikës së Serbisë shpaloset gjatë votimit në zgjedhjet për organet shtetërore në vendvotimet.)

- **Formularët e vërtetimit për të drejtën e votës për të votuar jashtë vendvotimit (për të dy proceset zgjedhore)**

(Vërtetimi për të drejtën e votës për të votuar jashtë vendvotimit është një dokument i cili shërben që votuesi i cili voton jashtë vendvotimit, duke e nënshkruar, të verifikojë që ka votuar. Nënshkrimi i këtij verifikimi zëvendëson nënshkrimin e votuesit në ekstraktin nga lista e votuesve.)

- **Formularët e evidencës mbi praninë e anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme, përkatësisht të zgjeruar në vendvotim, në dy kopje.**

(Evidenca e pranisë në vendvotim të përbërjes së përhershme të këshillit të vendvotimit dhe evidenca e pranisë në vendvotim të përbërjes së zgjeruar shërben që të përcaktohet se kush nga anëtarët dhe zëvendësanëtarët ishte në të vërtetë në vendvotim dhe ka marrë pjesë në punën e këshillit të vendvotimit. Kompensimi për punën në këshillin e vendvotimit u paguhet vetëm atyre personave që janë regjistruar në evidencat e lartpërmendura.

Duhet pasur parasysh që nënshkrimi i evidencës së pranisë NUK ZËVENDËSON nënshkrimin e procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit.)

- **Listën e përfaqësuesve të vëzhguesve vendorë dhe të huaj të akredituar për monitorimin e punës së këshillave të vendvotimeve.**

(Kjo listë shërben që këshilli i vendvotimit të kontrollojë nëse përfaqësuesi i vëzhguesve i cili erdhi në vendvotim dhe posedon akreditimin e lëshuar nga KQZ-ja, është autorizuar në të vërtetë që të marrë pjesë në vendvotimin konkret.)

- **Posterat informues për votuesit**


(Posterat informues për votuesit shpallen në vendvotim dhe shërbejnë për të edukuar votuesit për mënyrën e zbatimit të votimit)

- **Kartat identifikuese për anëtarët e këshillave të vendvotimeve me kapëset**




(Kartat identifikuese shërbejnë për të përcaktuar nëse personat e pranishëm në vendvotim janë të autorizuar për zbatimin e votimit në vendvotim.)


- **Shenjën e vendvotimit dhe dy shenja për kutitë e votimit (për të dy proceset zgjedhore)**
- **DY kuti të votimit (për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale)**
- **Paravanet për të siguruar fshehtësinë e votimit**



- **dy sprejë për të shënuar gishtin e votuesit**




- **dy llamba UV**




- **bateritë për llambat UV**

- **Pajisje shkrimi (stilolapsa dhe flomastra)**



- **stikerat për vulosjen e kutisë së votimit, si edhe stikerat për të vulosur zarfet me fletëvotimet pas votimit, përkatësisht letrat në formë shiritash për fletëvotimet me format më të madh**

- zarfet për ruajtjen e fletëvotimeve, fletës kontrolluese dhe verifikimit për të drejtën e votës për të votuar jashtë vendvotimit



- materialin e tjerë të zyrës (gërshërët, shiritin ngjitës, fijen e vulosjes, vizoren dhe një letër shkrimi)



! VËMENDJE:

Anëtarët e këshillit të vendvotimit të cilët marrin materialin zgjedhor, dhe ky është më së shpeshti kryetari i këshillit të vendvotimit, duhet të kujdesen që të marrin të gjithë materialin e përmendur në procesverbalet e dorëzimit, nga të cilat **më të rëndësishmet patjetër janë fletëvotimet e veçanta për çdo zgjedhje, ekstraktet nga lista e votuesve veçmas për secilën zgjedhje, fletët kontrolluese për kontrollimin e rregullsisë së çdo kutie të votimit dhe procesverbalet për punën e këshillit të vendvotimit veçmas për çdo zgjedhje.**

! VËMENDJE:

Gjatë dorëzimit, këshilli i vendvotimit duhet të marrë aq fletëvotime sa votues mund të votojnë në atë vendvotim. Lidhur me këtë **duhet të vini re nëse në vendvotim votojnë vetëm votuesit e regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve, ose ndoshta ekziston edhe një ekstrakt i veçantë nëse në atë vendvotim votojnë edhe votuesit të cilët janë në shërbimin ushtarak, ushtrimin ushtarak ose shkollimin në njësitë ose institucionet e Ushtrisë së Serbisë (në tekstin e mëtejshëm: votuesit në Ushtrinë e Serbisë).** Pra, nëse në një vendvotim ekziston edhe një ekstrakt i veçantë për votuesit në Ushtrinë e Serbisë, numri i fletëvotimeve i cili i dorëzohet këshillit të vendvotimit është i barabartë me shumën e numrave të votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve, votuesve të regjistruar në listën e mëvonshme të votuesve në Ushtrinë e Serbisë të regjistruar në ekstraktin e veçantë.

SHËNIM:

KQZ me udhëzimet e tij mund të parashikojë që këshillave të vendvotimeve t'u dorëzohet edhe ndonjë material tjetër (siç janë maskat dhe dorezat mbrojtëse), dhe për këtë arsye duhet pasur kujdes që gjatë dorëzimit të ndiqen pikat nga procesverbali për dorëzimin e materialit zgjedhor, përkatësisht nga procesverbali për

dorëzimin e materialit tjetër (në rast që KQZ të përpilojë procesverbalet e tilla).

VULOSJEN E THESIT ME MATERIALIN ZGJEDHOR

Pasi i është dorëzuar këshillit të vendvotimit i gjithë materiali i parashikuar (për të dy proceset zgjedhore), materiali, me **përjashtim të gërshtërëve**, futet në thasët e veçantë për ruajtjen e materialit zgjedhor (në një thes gri futet materiali zgjedhor për zgjedhjet parlamentare, ndërsa në thesin e kaltër futet materiali zgjedhor për zgjedhjet presidenciale).

Pasi është futur i gjithë materiali në thasët përkatës, thasët vulosen **me bllombat e sigurisë në prani të anëtarëve të këshillit të vendvotimit** (bllombat e bardha për zgjedhjet parlamentare, dhe bllombat e kaltra për zgjedhjet presidenciale), numrat serial të të cilave shkruhen në procesverbalin përkatës për dorëzimin e materialit zgjedhor.


Spreji për të shënuar gishtin e votuesit, llamba UV dhe materialet e zyrës futen në një thes për ruajtjen e materialit zgjedhor për deputetët popullorë.

SHËNIM:


Para vendosjes së materialit zgjedhor në thes, spreji për të shënuar gishtin e votuesit, llamba UB dhe materialet e zyrës duhet të futen në një thes të veçantë ose të vogël, i cili duhet të mbyllet/lidhet, në mënyrë që përmbajtja e tij të mos përfundojë nëpër thes.

Para vulosjes, në thasët ngjiten stikerat përkatës me shenjën e zgjedhjeve për deputetët popullorë përkatësisht zgjedhjeve për president të Republikës, në të cilat shkruhen emri i komunës/qytetit dhe numri i vendvotimit.

PARA PAKETIMIT NË THESIN PËR RUAJTJEN E MATERIALIT ZGJEDHOR, FUTNI SPREJIN, LLAMBËN UV DHE MATERIALET E ZYRËS NË NJË QESE FARMACIE OSE NJË THES TË VOGËL QË DUHET TË MBYLLET / LIDHET, NË MËNYRË QË PËRMBAJTJA E TIJ TË MOS SHPËRNDAHET BRENTA THESIT



QESE FARMACIE



LIDHËSE E SIGURISË

NGJITËSE

THESI PËR RUAJTJEN E MATERIALIT ZGJEDHOR

! VËMENDJE:

1. Thasët e vulosur me materialin zgjedhor nuk duhet të hapen para se të mblidhet këshilli i vendvotimit në ditën e votimit në vendvotim.

2. Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor para votimit Komisioni komunal zgjedhor duhet të kujdeset që:

- materiali zgjedhor për çdo zgjedhje të paketohe në thasët e veçantë (**thesi gri për zgjedhjet parlamentare dhe thesi i kaltër për zgjedhjet presidenciale**);

- çdo thes me materialin zgjedhor të shënohet me një stikerin përkatës në të cilin janë shkruar emri i komunës/qytetit dhe numri i vendvotimit;

- këshilli i vendvotimit të marrë aq kuti të votimit sa zgjedhje zbatohen në vendvotim

SHËNIM:

Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor, komisioni komunal zgjedhor duhet t'i japë këshillit të vendvotimit numrin e telefonit të personit i cili do të jetë i detyrueshëm që në ditën e votimit të hapë objektin në të cilin ndodhet vendvotimi.

DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR PËR VOTIM JASHTË VENDIT

Për dorëzimin e materialit zgjedhor për votim jashtë vendit janë përcaktuar rregullat e veçanta Këtë material ua dorëzon këshillave të vendvotimeve drejtpërdrejt koordinuesi i KQZ-së, dhe jo komisioni komunal zgjedhor.

Dorëzimi kryhet në selinë e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Për dorëzimin përpilohen procesverbalet e veçanta për të dy proceset zgjedhore.

Kryetari i këshillit të vendvotimit e transporton materialin zgjedhor në vendvotim jashtë vendit ashtu siç dërgohen dërgesat diplomatike, duke e mundur kështu sigurinë e materialit zgjedhor.

3. PËRGATITJA PËR FILLIMIN E VOTIMIT

Në ditën e votimit, **më 3 prill 2022, KËSHILLI I VENDOVIMIT TAKOHET MË SË VONI NË ORËN 6.00 NË VENDVOTIM**, me qëllim që t'i kryejnë të gjitha përgatitjet për fillimin e votimit.

! VËMENDJE:

Anëtari i këshillit të vendvotimit ose zëvendësi i tij duhet të jenë të pranishëm në vendvotim, filluar nga mbledhja e këshillit të vendvotimit në ditën e votimit, deri në përcaktimin e rezultateve të votimit në vendvotim dhe plotësimin e procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit.

! VËMENDJE:

Anëtari i këshillit të vendvotimit dhe zëvendësi i tij mund të jenë të pranishëm njëkohësisht në vendvotim, ose mund të zëvendësohen. Prandaj, këshilli i vendvotimit nuk mund t'i ndalojë zëvendësit të anëtarit të pranishëm të këshillit të vendvotimit që të jetë në vendvotim së bashku me anëtarin të cilin e zëvendëson. Në rast që të vlerësojë se prania e numrit të madh të anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit në përbërje të zgjeruar e vë në rrezik fshehtësinë e votimit, kryetari i këshillit të vendvotimit duhet t'u shpjegojë se nuk ka nevojë për praninë e njëkohshme edhe të anëtarit të këshillit të vendvotimit edhe të zëvendësit të tij.

SHËNIM:

Në përgatitjet për fillimin e votimit mund të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e vëzhguesve të akredituar nga KQZ.

Përgatitja për fillimin e votimit nënkupton tri faza:

1. përcaktimin e plotësisë dhe rregullsisë së materialit zgjedhor (për të dy proceset zgjedhore)
2. rregullimin e vendvotimit
3. marrëveshjen për ndarjen e detyrave

3.1. PËRCAKTIMI I PLOTËSISË DHE RREGULLSISË SË MATERIALIT ZGJEDHOR

Kryetari i këshillit të vendvotimit pret me **gërshërët** bllobat e sigurisë nga të dy thasët, **të cilët duhet t'i ruajë dhe t'ia dorëzojë detyrimisht pas votimit komisionit komunal zgjedhor.**

Pastaj gjendja e materialit zgjedhor në thasët (për të dy proceset zgjedhore) krahasohet me të dhënat nga procesverbali për dorëzimin e materialit zgjedhor para votimit dhe në këtë mënyrë përcaktohet nëse materiali i marrë është i plotë dhe i rregullt. Në rast se mungon ndonjë material zgjedhor për zgjedhjet parlamentare ose presidenciale nga procesverbali për dorëzimin, për këtë duhet të njoftohet menjëherë komisioni komunal zgjedhor.

! VËMENDJE:

Fletëvotimet i dorëzohen këshillit të vendvotimit të paketuara në zarfet me nga 100 fletëvotime dhe, sipas rregullit, me një zarf në të cilën ka më pak se 100 fletëvotime. Për shembull, nëse në një vendvotim votojnë 558 votues, këshillit të vendvotimit do t'i dorëzohen pesë zarfe me nga 100 fletëvotime dhe një (zarfi i gjashtë) në të cilin do të ketë 58 fletëvotime. Gjatë përgatitjes për fillimin e votimit, këshilli i vendvotimit duhet të hapë vetëm zarfin me më pak se 100 votues, ndërsa zarfi tjetër (zarfi me 100 fletëvotime) hapet vetëm pasi ka votuar ai numri i votuesve i cili i përshtatet numrit të fletëvotimeve në zarfin me më pak se 100 fletëvotime. Në përputhje me këtë, në shembullin e vendvotimit me 558 votues, kontrolli nëse këshillit të vendvotimit i është dorëzuar numri i mjaftueshëm i fletëvotimeve nënkupton numërimin (**pa hapur zarfet**) nëse në thesin ka numër të përshtatshëm të zarfeve me nga 100 fletëvotime dhe kontrolli nëse në zarfin me jo më shumë se 100 fletëvotime ka 58 fletëvotime.

Në mënyrë që të fillojë votimi, është **E DOMOSDOSHME** që në vendvotim të gjendet materiali zgjedhor në vijim:

- Lista përmbledhëse e kandidatëve për deputetët popullorë dhe Lista e kandidatëve për zgjedhjen e presidentit të Republikës

- ekstrakti nga lista e votuesve për zgjedhjen e deputetëve popullorë dhe ekstrakti nga lista e votuesve për zgjedhjen e presidentit të Republikës
- ekstraktet e veçanta nga lista e votuesve për të dy zgjedhjet, nëse në vendvotim votojnë votuesit në Ushtrinë e Serbisë
- fletëvotimet për të dy zgjedhjet (**numri i saktë nuk është i domosdoshëm!**)
- fletët kontrolluese për kontrollin e rregullsisë së kutive të votimit për të dy zgjedhjet
- kutia e votimit për zgjedhjet parlamentare dhe kutia e votimit për zgjedhjet presidenciale
- një sprej për të shënuar gishtin e votuesit
- një llambë UV
- të paktën një paravan për të siguruar fshehtësinë e votimit
- fija e vulosjes dhe stikerat për të vulosur kutinë e votimit

Nëse mungon diçka nga këto materiale, votimi nuk mund të fillojë.

! VËMENDJE:

Nëse këshillit të vendvotimit nuk i është dorëzuar numri i fletëvotimeve i cili i përshtatet numrit të votuesve që votojnë në një vendvotim për njërin nga proceset zgjedhore, kjo nuk është arsye që këshilli i vendvotimit të mos hapë vendvotimin dhe të mos fillojë votimi. Pra, këshilli i vendvotimit në këtë rast duhet të vazhdojë veprimet përgatitëse dhe të mundësojë fillimin e votimit në vendvotim.


3.2. RREGULLIMI I VENDVOTIMIT

Pasi e verifikojnë materialin zgjedhor të domosdoshëm për fillimin e votimit, anëtarët e këshillit të vendvotimit fillojnë të rregullojnë vendvotimin:

- së pari të hyrja në objektin në të cilin gjendet vendvotimi shfaqen numri dhe emri i vendvotimit

- nëse në këtë objekt ka disa vendvotime ose nëse bëhet fjalë për ndonjë objekt të madh me një vendvotim, administrata e komunës/qytetit duhet të kujdeset për vendosjen e udhëreguesve përkatës
- te hyrja në ambientin në të cilin gjendet vendvotimi shpallet numri dhe emri i vendvotimit
- në ambientin në të cilin gjendet vendvotimi shpaloset Flamuri shtetëror i Republikës së Serbisë
- Lista përmbledhëse zgjedhore dhe Lista e kandidatëve për zgjedhjen e presidentit të Republikës shfaqen detyrimisht para ambientit në të cilin gjendet vendvotimi
- posterat informues për votuesit shfaqen detyrimisht para ambientit në të cilin gjendet vendvotimi

Shtojca 6 – Skema e rregullimit të vendvotimit



Pastaj ambienti nga hyrja deri te kutia e votimit rregullohet në mënyrë që vendet për kryerjen e veprimeve zgjedhore të vendosen detyrimisht me renditje të mëposhtme:

- vendi në të cilin kryhet kontrolli me llambën UV

- vendi në të cilin verifikohet identiteti i votuesit
- vendi në të cilin gjendet **ekstrakti nga lista e votuesve për zgjedhjen e deputetëve popullorë** dhe një ekstrakt i veçantë nga lista e votuesve për zgjedhjen e deputetëve popullorë për votuesit në Ushtrinë e Serbisë nëse votojnë në atë vendvotim.
- vendi në të cilin gjendjet ekstrakti **nga lista e votuesve për zgjedhjen e presidentit të Republikës** dhe një ekstrakt i veçantë nga lista e votuesve për zgjedhjen e presidentit të Republikës për votuesit në Ushtrinë e Serbisë nëse votojnë në atë vendvotim
- vendi në të cilin gishti i votuesit shënohet me sprej
- vendi në të cilin dorëzohen fletëvotimet **për zgjedhjen e deputetëve popullorë**
- vendi në të cilin dorëzohen fletëvotimet **për zgjedhjen e presidentit të Republikës**
- vendi në të cilin anëtari i këshillit të vendvotimit edukon votuesit për mënyrën e votimit;
- paravanet për të siguruar fshehtësinë e votimit
- kutia e votimit **për zgjedhjen e deputetëve popullorë**
- kutia e votimit **për zgjedhjen e presidentit të Republikës**

! VËMENDJE:


Paravanet e votimit duhet të vendosen në mënyrë që të sigurojnë fshehtësinë e votimit, përkatësisht në mënyrë që askush nga anëtarët e këshillit të vendvotimit, përfaqësuesit e vëzhguesve, gazetarët ose votuesit e tjerë të mos e shohë votuesin duke plotësuar fletëvotimin.

Gjithashtu, hyrja e paravanit duhet të jetë e kthyer nga muri, me ç'rast distanca midis paravaneve duhet të jetë të paktën një metër.

SHËNIM:

1. Në kutinë e votimit për zgjedhjen e deputetëve popullorë ngjitet detyrimisht një letër që shërben si shenjë e kutisë së votimit dhe ka një shënim se kutia e votimit është destinuar për votim në zgjedhjet për deputetët popullorë.

2. Në kutinë e votimit për zgjedhjen e presidentit të Republikës ngjitet detyrimisht një letër që shërben si shenjë e kutisë së votimit dhe ka një shënim se kutia e votimit është destinuar për votim në zgjedhjet për president të Republikës.



Skema e vendvotimit për zgjedhjet të cilat do të mbahen më 3 prill 2022

Përveç rregullimit të ambientit në të cilin duhet të votohet, këshilli i vendvotimit duhet të kontrollojë nëse në këtë ambient, ose drejtpërdrejt para vendvotimit **janë shfaqur simbolet e partisë politike dhe të paraqitësit të listës së shpallur zgjedhore ose të propozuesit të kandidatit për president të Republikës, si edhe materiali tjetër zgjedhor propagandues** (të partive politike, koalicioneve partiake, grupeve të qytetarëve). Nëse verifikohet që është shfaqur një material i tillë, këshilli i vendvotimit duhet ta heqë atë, dhe nëse nuk mundet, duhet ta njoftojë komisionin komunal zgjedhor për këtë, i cili do të njoftojë shërbimin kompetent komunal.

SHËNIM:

Këshilli i vendvotimit duhet të kujdeset gjatë gjithë kohës së votimit që në ambientin e votimit ose drejtpërdrejt para vendvotimit të mos jetë i shfaqur ndonjë material zgjedhor propagandues.

MBAJTJA E NJËKOHSHME E ZGJEDHJEVE LOKALE ME ZGJEDHJET PARLAMENTARE


Në ato komuna/qytete në të cilat së bashku me zgjedhjet parlamentare do të mbahen edhe zgjedhjet lokale, pas vendit për ekstraktin nga lista e votuesve për zgjedhjet presidenciale, duhet të sigurohet një vend për ekstraktin nga lista e votuesve për zgjedhjet lokale, ndërsa vendi në të cilin dorëzohen fletëvotimet për zgjedhjet lokale duhet të gjendet pas vendit në të cilin dorëzohen fletëvotimet për zgjedhjet presidenciale.

Gjithashtu, pranë vendit në të cilin gjenden kutitë e votimit për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale, duhet të sigurohet edhe një vend për kutinë e votimit për zgjedhjet lokale.

! VËMENDJE E VEÇANTË:

Numri i madh i këshillave të vendvotimeve, kur në një vendvotim votohet në disa zgjedhje, dhe ka më shumë se një kuti të votimit, në kutitë e votimit, në vend të letrës me shenjën e zgjedhjeve, ngjit fletëvotimet, me qëllim që votuesit të dinë në të cilën kuti duhet të hedhin fletëvotimin. Nëse veprohet kështu (**gabim**), këshilli i vendvotimit nuk duhet të harrojë që këto fletëvotime, pas mbarimit të votimit, t'i heqë nga kutitë e votimit dhe t'i përfshijë në fletëvotimet e papërdorura!

Shtojca 11: Skema e rregullimit të ambientit të votimit



Skema e vendvotimit në të cilën më 3 prill 2022 do të mbahen edhe zgjedhjet lokale njëkohësisht me zgjedhjet parlamentare .

3.3. MARRËVESHJA PËR NDARJEN E DETYRAVE

Pas përfundimit të rregullimit të vendvotimit, anëtarët e këshillit të vendvotimit bien dakord për ndarjen e detyrave gjatë zbatimit të votimit. Është më e rëndësishme që të përcaktohet se cilët anëtarë, ose zëvendësanëtarë do të jenë të ngarkuar me zbatimin e veprimeve të mëposhtme:

- përdorimi i llambës UV
- verifikimi i identitetit të votuesit
- përdorimi i ekstraktit nga lista e votuesve për zgjedhjen e deputetëve popullorë dhe ekstraktit të veçantë nga lista e votuesve për votuesit në Ushtrinë e Serbisë për zgjedhjen e deputetëve popullorë
- përdorimi i ekstraktit nga lista e votuesve për zgjedhjen e presidentit të Republikës dhe ekstraktit të veçantë nga lista e votuesve për votuesit në Ushtrinë e Serbisë për zgjedhjen e presidentit të Republikës
- përdorimi i sprejit për të shënuar gishtin e votuesit
- ruajtja dhe dorëzimi i fletëvotimeve për zgjedhjen e deputetëve popullorë
- ruajtja dhe dorëzimi i fletëvotimeve për zgjedhjen e presidentit të Republikës
- edukimi i votuesve për mënyrën e votimit;
- kujdesi që votuesit të hedhin fletëvotimet në kutitë përkatëse të votimit

Përveç kësaj, këshilli i vendvotimit duhet t'i përcaktojë edhe:

- **tre anëtarë ose zëvendësanëtarë të këshillit të vendvotimit të cilët janë emëruar me propozim të tre propozuesve të ndryshëm të autorizuar (prej të cilëve të paktën njëri është emëruar me propozim të listës opozitare zgjedhore/propozuesit opozitar të kandidatit për president të Republikës) dhe të cilët, si komisionerë të këshillit të vendvotimit, do të zbatojnë votimin jashtë vendvotimit**
- një anëtar ose zëvendësanëtar të këshillit të vendvotimit i cili **do të jetë i ngarkuar me plotësimin e formularëve kontrollues dhe kryerjen e kontrollit logjiko-**

Ilogaritës të rezultateve të votimit të shënuara në formularët kontrollues (për të dy proceset e votimit)

! VËMENDJE E VEÇANTË:

Ndarja e detyrave nuk do të thotë që për secilën detyrë të veçantë mund të përcaktohet vetëm një anëtar i këshillit të vendvotimit, përkundrazi. Është e dëshirueshme që anëtarët e këshillit të vendvotimit të ndërrohen në kryerjen e punëve të lidhura me zbatimin e votimit.

Kryetari i këshillit të vendvotimit është i detyruar që të inkurajojë veçanërisht anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këshillit të vendvotimit të cilët janë emëruar me propozim të listës opozitare zgjedhore/propozuesit opozitar të kandidatit për president të Republikës që të kontrollojnë veçanërisht disa veprime zgjedhore, siç janë: kontrolli i rregullsisë së kutisë së votimit, ndarja e fletëvotimeve në të vlefshmet dhe të pavlefshmet dhe numërimi i votave të marra nga listat zgjedhore.

3.4. PLOTËSIMI E FORMULARËVE PËR PUNËN E KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT PARA HAPJES SË VENDVOTIMIT

Pasi i ka kryer të gjitha veprimet e lartpërmendura, dhe para se të hapë vendvotimin, këshilli i vendvotimit duhet t'i plotësojë katër pikat e para të Procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, si më poshtë:

- në pikën 1 të shkruajë numrin e vendvotimit;
- në pikën 2 të shkruajë emrin e komunës / qytetit / entit / shtetit të huaj;
- në pikën 3 të shkruajë datën e mbajtjes së votimit;
- në pikën 4 të shkruajë numrin e votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve.

! VËMENDJE:

Përcaktimi i numrit të votuesve **të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve nënkupton jo vetëm përcaktimin e numrit të votuesve nga vetë ekstrakti**, por duhet të kujdeseni edhe **për listën e ndryshimeve të mëvonshme në listën e votuesve, nëse është dorëzuar ekstrakti nga lista e votuesve**. Gjithashtu, duhet të keni kujdes që në këtë listë eventuale të ndryshimeve të mëvonshme mund të gjenden jo vetëm votuesit e regjistruar më vonë në listën e votuesve për atë vendvotim, por edhe votuesit të cilët janë fshirë nga ky vendvotim, ose edhe votuesit që nuk janë as të regjistruar as të fshirë, por vetëm kanë ndryshuar një nga të dhënat në ekstraktin nga lista e votuesve, për shembull mbiemrin. Prandaj, **këshilli i vendvotimit duhet të kujdeset që gjatë përcaktimit të numrit të votuesve t'i numërojë dhe ata të cilët janë regjistruar më vonë, dhe t'i heqë ata të fshirë!**

Përveç kësaj, këshilli i vendvotimit duhet t'i kushtojë vëmendje edhe **ekstraktit eventual të veçantë nga lista e votuesve për votuesit në Ushtrinë e Serbisë**, dhe t'i numërojë ata në numrin e përgjithshëm të votuesve.

Për shembull Në ekstraktin janë regjistruar 578 votues. Në listën e ndryshimeve të mëvonshme janë regjistruar 5 votues të cilët janë shtuar në këtë vendvotim, 3 votues të cilët janë fshirë nga ky vendvotim dhe 7 votues të cilët kanë ndryshuar mbiemrin ose ndonjë tjetër informacion personal, që do të thotë se ata nuk janë as të shtuar as të fshirë. Në ekstraktin e veçantë për votuesit në Ushtrinë e Serbisë janë regjistruar 44 votues. Kjo do të thotë që në këtë vendvotim janë regjistruar gjithsej 624 votues (578+5-3+44).

SHËNIM:

Numrin përfundimtar të votuesve të regjistruar në vendvotim këshilli i vendvotimit mund ta kontrollojë edhe përmes njoftimit që dorëzohet së bashku me listën e ndryshimeve të mëvonshme, nëse është dorëzuar një listë e tillë për vendvotimin. Pra, KQZ do të dorëzojë një njoftim me numrin përfundimtar të votuesve në vendvotim për vendvotimet në të cilat ka ndryshime të mëvonshme në listën e votuesve. Këshilli

i vendvotimit, nëse e merr këtë njoftim, vetëm duhet të kopjojë numrin e saktë të votuesve i cili gjendet në njoftim.

! VËMENDJE:

Në ato vendvotime ku ekzistojnë procesverbalet për punën e këshillit të vendvotimit edhe në gjuhët e pakicave kombëtare, këshilli i vendvotimit duhet të kujdeset që të gjitha të dhënat të shkruhen detyrimisht në të gjitha procesverbalet në ato gjuhë.

4. HAPJA E VENDVOTIMIT

Pasi ka kryer të gjitha përgatitjet për zbatimin e votimit **dhe pasi të gjithë anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këshillit të vendvotimit kanë varur kartat e tyre identifikuese në një vend të dukshëm**, këshilli i vendvotimit konstaton se votimi mund të fillojë.

SHËNIM:

Anëtarët e këshillit të vendvotimit duhet të mbajnë kartat e tyre identifikuese gjithë kohën derisa janë në vendvotim.

SHËNIM:

Kryetari i këshillit të vendvotimit ka për detyrë që, **gjatë gjithë ditës**, të kujdeset që anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këshillit të vendvotimit të regjistrohen në **evidencën përkatëse të pranisë së anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar**, e cila shërben si bazë për pagesën e kompensimit për punë në këshillin e vendvotimit.

! VËMENDJE:

Kryetari i këshillit të vendvotimit duhet t'u thotë anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit që evidentimi i pranisë së tyre në vendvotim nuk e zëvendëson, përkatësisht nuk e përjashton obligimin e nënshkrimit të Procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit në fund të punës së këshillit të vendvotimit, duke marrë parasysh se kjo është detyra e tyre ligjore.

Në përputhje me ligjin, vendvotimet hapen **në orën 7.00**, dhe mbyllen në **orën 20.00** dhe gjatë kësaj kohe vendvotimi duhet të jetë e hapur pa ndërprerje.

Në pikën 5 të Procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit, është e domosdoshme, **menjëherë pas hapjes së vendvotimit, të shënohet koha e hapjes së vendvotimit.**

KONTROLLI I RREGULLSISË SË KUTISË SË VOTIMIT - PLOTËSIMI E FLETËS KONTROLLUESE

Pasi është hapur vendvotimi dhe pasi ka ardhur votuesi i parë në vendvotim, kryhet kontrolli i rregullsisë së kutive të votimit duke përcaktuar nëse janë të rregullta dhe të zbrazëta, dhe pas kësaj plotësohen të dy fletët kontrolluese për kontrollin e rregullsisë së kutisë së votimit (për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale), të cilat nënshkruhen nga të gjithë anëtarët dhe zëvendësanëtarët e pranishëm të këshillit të vendvotimit dhe votuesi i parë.

Pas kësaj në Procesverbalin për punën e këshillit të vendvotimit për zbatimin e votimit për zgjedhjen e deputetëve popullorë dhe Procesverbalin për punën e këshillit të vendvotimit për zbatimin e votimit për zgjedhjen e presidentit të Republikës shkruhen:

- emri dhe mbiemri i votuesit të parë në vendvotim - **pika 6 e të dy procesverbaleve**
- numri me të cilin është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve votuesi i parë në vendvotim - **pika 7 e të dy procesverbaleve**

! VËMENDJE:

Kur votuesi i parë vjen në vendvotim, para kontrollit të rregullsisë së kutive të votimit, këshilli i vendvotimit e kontrollon detyrimisht me llambën UV nëse votuesi ndoshta tashmë ka votuar diku, pastaj verifikon identitetin e tij me dokumentin përkatës dhe kontrollon nëse është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve.

Rregullsia e kutive të votimit nuk mund të kontrollohet në prani të votuesit për të cilin, pas kontrollimit me llambën UV, është konstatuar se ka votuar në një vendvotim tjetër, i cili nuk ka dokumentin publik të vlefshëm për verifikim të identitetit, i cili nuk është regjistruar në ekstraktet nga lista e votuesve dhe i cili është anëtar i këshillit të vendvotimit në atë vendvotim.

Pas plotësimit dhe nënshkrimit të fletëve kontrolluese, ato hidhen në kutinë përkatëse të votimit (në varësi nga zgjedhjet për të cilat përdoret kjo kuti votimi).

! VËMENDJE:


Duhet të kujdeseni që fleta kontrolluese për kontrollimin e kutisë së votimit për zgjedhjet për deputetët popullorë të hidhet vetëm në kutinë e votimit për ato zgjedhje, përkatësisht të mos hidhet gabimisht në kutinë e votimit për zgjedhjen e presidentit të Republikës, ose anasjelltas!

Pas hedhjes së fletave kontrolluese në kutitë përkatëse të votimit, kutitë mbyllen dhe vulosen duke përdorur fijen e vulosjes dhe stikerin për vulosjen e kutive të votimit.

MBAJTJA E NJËKOHSHME E ZGJEDHJEVE LOKALE ME ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Në ato vendvotime në të cilat njëkohësisht me zgjedhjet parlamentare do të votohet edhe në zgjedhjet lokale, **mund të ndodhë situata që një votues të jetë i regjistruar vetëm në ekstraktin nga lista e votuesve për zgjedhjet parlamentare, por jo edhe në ekstraktin për zgjedhjet lokale, dhe anasjelltas!** Këshilli i vendvotimit duhet ta ketë parasysh këtë, dhe të kontrollojë detyrimisht nëse votuesi i parë që erdhi në vendvotim është regjistruar në të gjitha ekstraktet nga lista e votuesve. Nëse nuk është, procedura e kontrollit të rregullsisë së kutisë së votimit kryhet vetëm për ato zgjedhje në të cilat mund të votojë ky votues.

Vetëm pasi të bëhen të gjitha veprimet e lartpërmendura, këshilli i vendvotimit do t'i mundësojë votuesit të parë të votojë.



IMAZHI I KUTISË SË VOTIMIT ME FIJEN E VULOSJES DHE NGJITËSEN

5. VOTIMI NË VENDVOTIM

Votuesi voton në vendvotimin në të cilin është regjistruar në ekstraktet nga lista e votuesve. Në mënyrë përjashtimore, votuesi mund të votojë edhe jashtë vendvotimit në të cilin është regjistruar në ekstraktet nga lista e votuesve, me kusht që të bëhet fjalë për personin i cili nuk mund të votojë në vendvotim për shkak të sëmundjes së rëndë, pleqërisë ose aftësisë së kufizuar.

Votuesit të cilët janë në paraburgim ose vuajnë sanksionet penale mund të votojnë në vendvotim brenda institucionit të vuajtjes së sanksioneve penale në të cilin gjenden.

Votuesit në Ushtrinë e Serbisë mund të votojnë në vendvotimet më të afërta me njësinë ose institucionin në të cilin gjenden.

Secilit votuesi, jo më vonë se pesë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, i dorëzohet detyrimisht ftesa për votim e cila përmban: datën dhe orën e votimit, numrin dhe adresën e vendvotimit dhe numrin me të cilin është regjistruar votuesi në ekstraktet nga lista e votuesve.

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Për zgjedhjet parlamentare votuesit do të marrin **vetëm një ftesë për votim** e cila, pra, i referohet edhe votimit në zgjedhjet për deputetët popullorë edhe votimit në zgjedhjet për president të Republikës.

! VËMENDJE:

Këshilli i vendvotimit është i detyruar që personit i cili lëviz me anë të qenit udhërrëfyes dhe ka dokumentin përkatës për lëvizje me anë të qenit udhërrëfyes t'i mundësojë qasjen e lirë në objektin në të cilin gjendet vendvotimi dhe në vetë vendvotim.

Nën dokumentin përkatës për lëvizje me anë të qenit udhërrëfyes konsiderohen:


- 1) provë për njohuritë dhe aftësitë e fituara për të lëvizur me qenin udhërrëfyes - për personin i cili lëviz me anë të qenit udhërrëfyes
- 2) provë për stërvitjen e përfunduar - për qenin udhërrëfyes



Kur një votues vjen në vendvotim, këshilli i vendvotimit ndërmerr veprimet e mëposhtme:

- kontrollojnë me llambën UV nëse votuesi ka votuar në një vendvotim tjetër
- verifikojnë identitetin e votuesit
- kontrollojnë nëse votuesi është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve për zgjedhjen e deputetëve popullorë
- kontrollojnë nëse votuesi është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve për zgjedhjen e presidentit të Republikës
- shënojnë votuesin me sprej
- i dorëzojnë votuesit fletëvotimin për zgjedhjen e deputetëve popullorë
- i dorëzojnë votuesit fletëvotimin për zgjedhjen e presidentit të Republikës

VEPRIMI I PARË: KONTROLLI ME LLAMBËN UV NËSE VOTUESI KA VOTUAR NË NJË VENDVOTIM TJETËR




KONTROLLI ME LLAMBËN UV nënkupton kontrollin nëse gishti treguesi i dorës së djathtë të votuesit tashmë është shënuar me ngjyrë të padukshme UV.

Në rast se votuesi nuk e ka gishtin tregues të dorës së djathtë, kontrollohet nëse është shënuar gishti tjetër djathtas dhe përfundimisht gishti i madh i asaj dore, nën rrënjën e thoit.

Në rast se votuesi nuk ka dorën e djathtë, kontrollohet nëse është shënuar gishti tregues i dorës së majtë, përkatësisht gishti tjetër majtas dhe përfundimisht gishti i madh i kësaj dore, nën rrënjën e thoit.

Nëse votuesi nuk ka duart, kontrolli me llambën UV nuk kryhet.



Nëse vërtetohet me llambën UV ekzistimi i gjurmëve të ngjyrës UV nga spreji me të cilin shënohet gishti i votuesit, konsiderohet se votuesi tashmë ka votuar në një vendvotim tjetër, dhe këshilli i vendvotimit nuk mund t'i lejojë që të votojë, dhe votuesi është i detyruar që të largohet menjëherë nga vendvotimi.

! VËMENDJE:

Përgjashtimisht, anëtarëve të këshillave të vendvotimeve të cilët janë zgjedhur të përdorin sprejin për shënimin e gishtit të votuesit duhet t'u lejohet votimi në vendvotimin e tyre me vendimin për emërimin e anëtarit të këshillit të vendvotimit!

VEPRIMI I DYTË: VERIFIKIMI I IDENTITETIT E VOTUESIT

Pasi është verifikuar se votuesi nuk ka votuar, këshilli i vendvotimit duhet të **VERFIKOJË IDENTITETIN E VOTUESIT**. Verifikimi i identitetit të votuesit bëhet në mënyrë që votuesi i afrohet anëtarit të radhës të këshillit të vendvotimit, ia tregon emrin dhe

mbiemrin e vet dhe i dorëzon ftesën për votim, **nëse e ka me vete**, duke dëshmuar identitetin e vet.

! VËMENDJE:

Votuesi nuk është i detyruar që ta marrë me vete ftesën për votim në vendvotim dhe këshilli i vendvotimit nuk mund ta ndalojë atë votues që të votojë vetëm për shkak të mungesës së ftesës.


Votuesi dëshmon identitetin e tij **me letërnjoftim të vlefshëm ose një dokument të vlefshëm udhëtimi (pasaportë).**



Këshilli i vendvotimit duhet t'i lejojë votimin votuesit i cili dëshmon identitetin e tij me letërnjoftim ose pasaportë të skaduar, me kusht që të paraqesë një vërtetim të Ministrisë së Punëve të Brendshme me të cilën dëshmon se ka paraqitur kërkesën për lëshimin e letërnjoftimit të ri ose pasaportës së re.

Për të dëshmuar identitetin nuk mund të përdoret patentë shoferi, sepse nuk përmban NPI-në e votuesit.

Nëse në vendvotim votojnë votuesit në Ushtrinë e Serbisë, ata mund të dëshmojnë identitetin e tyre edhe me një identifikimin ushtarak që përmban fotografinë e votuesit dhe numrin e tij personal të identifikimit.



Votuesi i cili voton në një vendvotim brenda **entit për ekzekutimin e sanksioneve penale** mund të dëshmojë identitetin e tij edhe me një dokument përkatës të lëshuar nga ky ent.

! VËMENDJE:

Në praktikë mund të ndodhë dhe rasti që në vendvotim të vijë një votues i cili ka një dokument të vlefshëm në **të cilin është shënuar një mbiemër tjetër i ndryshëm nga mbiemri në ekstraktin nga lista e votuesve**. Në këtë rast, këshilli i vendvotimit duhet t'i lejojë këtij votuesi që të votojë, pa marrë parasysh këtë rrethanë, me kusht që mund të dëshmohet se bëhet fjalë për të njëjtin person në bazë të fotografisë së votuesit dhe numrit personal identifikues nga dokumenti me të cilin dëshmohet identiteti i tij.

VEPRIMI I TRETË: KONTROLLI NËSE VOTUESI ËSHTË REGJISTRUAR NË EKSTRAKTET NGA LISTA E VOTUESVE



Pasi ka konfirmuar identitetin e votuesit, këshilli i vendvotimit **KONTROLLON NËSE ËSHTË REGJISTRUAR VOTUESI NË EKSTRAKTET NGA LISTA E VOTUESVE.**

Kontrolli bëhet në mënyrë që një anëtar i këshillit të vendvotimit i ngarkuar për verifikimin e identitetit të votuesit ua komunikon anëtarëve të këshillit të vendvotimit të cilët janë të ngarkuar për menaxhimin e ekstrakteve nga lista e votuesve emrin, mbiemrin dhe NPI-në e votuesit dhe numrin rendor nga ekstrakti në ftesën për votim, nëse votuesi e ka marrë me vete.

Më pas, votuesi i afrohet anëtarit të këshillit të vendvotimit i cili është i ngarkuar me menaxhimin e ekstraktit nga lista e votuesve për zgjedhjen e deputetëve popullorë, i cili e gjen votuesin në ekstraktin dhe rrethon numrin rendor para mbiemrit të votuesit, dhe pas kësaj **votuesi nënshkruhet në vendin përkatës në ekstraktin.**

Pastaj, votuesi i afrohet anëtarit të këshillit të vendvotimit i cili është i ngarkuar për trajtimin e ekstraktit nga lista e votuesve për zgjedhjen e presidentit të Republikës, i cili gjen votuesin në ekstraktin dhe rrethon numrin rendor para mbiemrit të votuesit, dhe pa kësaj **votuesi nënshkruhet në vendin përkatës në ekstraktin.**

Nëse këshilli i vendvotimit nuk mund ta gjejë votuesin në ekstraktin nga lista e votuesve, duhet të kontrollojë nëse ky votues është regjistruar në listën e ndryshimeve të mëvonshme në listën e votuesve.

Lista e ndryshimeve të mëvonshme është një listë e votuesve të cilët, në bazë të vendimit të Ministrisë së Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale, janë regjistruar më vonë për votim në vendvotim, janë fshirë nga kjo listë e votuesve ose kanë ndryshuar ndonjë të dhënë personale.

Lista e ndryshimeve të mëvonshme përpilohet nga KQZ-ja dhe gjendet në aneksin e ekstrakteve përkatëse nga lista e votuesve, si pjesë përbërëse e saj.

Në qoftë se votuesi nuk është regjistruar as në ekstraktin nga lista e votuesve, as në listën e ndryshimeve të mëvonshme të listës së votuesve, këshilli i vendvotimit duhet të këshillojë votuesin që të kontrollojë se në të cilin vendvotim është regjistruar në listën e votuesve, duke kontrolluar në faqen e internetit <https://upit.birackispisak.gov.rs>, ose duke e kontaktuar me telefon Ministrinë e Administratës Shtetërore dhe Vetëqeverisjes Lokale.

Nëse një anëtar i këshillit të vendvotimit nuk mund ta gjejë votuesin në ekstraktin me mbiemrin nga dokumenti me të cilin ai dëshmon identitetin e vet, duhet ta pyesë votuesin nëse ka ndryshuar mbiemrin në periudhën e kaluar. Nëse votuesi ka ndryshuar mbiemrin, anëtari i këshillit të vendvotimit është i detyruar ta kërkojë në ekstraktin nga lista e votuesve edhe me atë mbiemër tjetër. Në rast se është regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve me mbiemrin tjetër, votuesit do t'i mundësohet votimi vetëm nëse NPI-ja e tij nga dokumenti me të cilin dëshmon identitetin e tij është identike me NPI-në në ekstraktin nga lista e votuesve.

! VËMENDJE:

Ligji ka ndaluar rreptësisht shtimin e mëvonshëm të votuesve në ekstraktin nga lista e votuesve. Shkelja e këtij ndalimi është bazë **për anulimin e votimit në vendvotim sipas detyrës zyrtare**. Prandaj këshilli i vendvotimit, në qoftë se nuk e gjen një person në ekstraktin nga lista e votuesve, **NUK MUNDET KURRSESI** ta shtojë më vonë në ekstraktin dhe nuk mund t'i lejojë të votojë, pa marrë parasysh faktin që e njeh ose që ky person pretendon se duhet të votojë në këtë vendvotim.

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Votuesi ka të drejtë të vendosë vetë në të cilat zgjedhje do të votojë.

Këshilli i vendvotimit nuk mund të detyrojë votuesin të votojë në të gjitha zgjedhjet që zbatohen në atë vendvotim nëse votuesi nuk e dëshiron këtë.

! VËMENDJE:

Anëtari i këshillit të vendvotimit është i detyruar të kujdeset që votuesi të nënshkruhet në rubrikën përkatëse, duke qenë se mund të ndodhë një situatë që **në ekstraktin nga lista e**

votuesve të regjistroheshin disa votues me të njëjtin emër dhe mbiemër.

Prandaj është e domosdoshme që përveç verifikimit të emrit personal të votuesit të **kontrollohet edhe NPI-ja e tij**, me qëllim që të dihet me siguri se po rrethohet personi i duhur në ekstrakt.

! VËMENDJE:

Në rast të mbajtjes së njëkohshme të zgjedhjeve lokale së bashku me zgjedhjet parlamentare, është e mundur që disa votues të mos jenë të regjistruar në të gjitha ekstraktet nga lista e votuesve (për shembull, personat të cilët janë regjistruar për votim sipas vendbanimit, nuk do të regjistrohen në vendvotimin e zgjedhur në ekstraktin nga lista e votuesve për votim në zgjedhjet lokale, por vetëm në ekstraktet për zgjedhjet parlamentare), kështu që duhet të kujdesemi që votuesit të mund të votojnë vetëm në ato zgjedhje për të cilat janë regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve, dhe këshilli i vendvotimit kurrsesi nuk mund të shtojë votues në ekstraktet në të cilat nuk janë regjistruar.


! VËMENDJE:

Votuesi i cili është person me aftësi të kufizuara dhe nuk është në gjendje të shkruajë me dorën e vet emrin dhe mbiemrin në ekstraktin nga lista e votuesve, mund të nënshkruhet duke e përdorur në vendin përkatës në ekstraktin nga lista e votuesve **një vulë e cila përmban të dhënat mbi identitetin e tij personal, përkatësisht vulën me nënshkrimin e gdhendur.**

Votuesi i cili është analfabet, përkatësisht votuesi i cili është person me aftësi të kufizuara dhe nuk posedon vulën e cila përmban të dhënat mbi identitetin e tij personal, lë gjurmën e gishtit, ose në vend të tij nënshkruhet ndihmësi i tij me emrin e vet, nëse e ka merrë me vete në vendvotim me qëllim të plotësimit së fletëvotimit.



VEPRIMI I KATËRT: SHËNIMI I VOTUESVE ME SPREJ



Pasi është nënshkruar në të gjitha ekstraktet nga lista e votuesve, votuesi i afrohet anëtarit të këshillit të vendvotimi i cili ia **SHËNON GISHTIN TREGUES TË DORËS SË DJATHTËME SPREJIN SPECIAL** nën rrënjën e thoit si shenjë votimi.


Votuesit i cili nuk ka gishtin tregues të dorës së djathtë do t'i shënohet gishti i radhës djathtas dhe përfundimisht gishti i madh kësaj dore, nën rrënjën e thoit.

Votuesit i cili nuk ka dorën e djathtë do t'i shënojnë gishtin tregues të dorës së majtë, përkatësisht gishtin e parë majtas dhe përfundimisht gishtin e madh, nën rrënjën e thoit.

Nëse votuesi nuk ka duart, shënimi nuk kryhet.

! VËMENDJE:

Në rast se votuesi refuzon për çfarëdo arsye që gishti i tij të shënohet me sprej, këshilli i vendvotimit nuk do t'ia dorëzojë fletëvotimin, përkatësisht nuk do t'i mundësojnë që të votojë.



VEPRIMI I PESTË: DORËZIMI I FLETËVOTIMIT



Pasi votuesit i është shënuar gishti tregues i dorës së djathtë me sprej special, anëtari tjetër i këshillit të vendvotimit ia dorëzon atij fletëvotimin për zgjedhjen e deputetëve popullorë, dhe anëtari tjetër i këshillit të vendvotimit ia dorëzon fletëvotimin për zgjedhjen e presidentit të Republikës.

VEPRIMI I GJASHTË: EDUKIMI I VOTUESIT


Pasi t'i dorëzohen fletëvotim votuesit, këshilli i vendvotimit ka për detyrë që ta edukojë votuesin, duke i treguar që:

- mund të votojë për njëren listë zgjedhore, përkatësisht për një kandidat për president të Republikës duke rrethuar

numrin rendor para emrit të kësaj liste zgjedhore, përkatësisht para emrit dhe mbiemrit të kandidatit për president të Republikës

- votimi është i fshehtë dhe bëhet prapa paravanit
- pasi ka plotësuar fletëvotimet, votuesi duhet t'i palosë në mënyrë që të mos shihet se si janë plotësuar fletëvotimet dhe kështu të palosura duhet t'i hedhë në kutinë përkatëse të votimit
- votimi është i lirë dhe askush nuk ka të drejtë ta pengojë ose ta detyrojë që të votojë, ta thërrasë në përgjegjësi sepse ka votuar ose nuk ka votuar ose të kërkojë nga ai të shprehet pse dhe kë ka votuar

VEPRIMI I SHITATË: VOTIMI I VOTUESVE



Pasi janë kryer të gjitha veprimet e mësipërme, votuesi mund të votojë, **dhe këshilli i vendvotimit do të drejtojë votuesin që të votojë prapa paravanit.**


FSHEHTËSIA E VOTIMIT

Këshilli i vendvotimit ka për detyrë të kujdeset për sigurimin e fshehtësisë së votimit.

Kjo veçanërisht nënkupton që këshilli i vendvotimit të kujdeset:

- që në vendvotim të jenë të pranishëm aq votues sa ka paravane
- që të bëjë distancë jo më pak se një metër midis pravaneve dhe t'i vendosë atp në një distancë të përshtatshme nga anëtarët e këshillit të vendvotimit dhe përfaqësuesit e vëzhguesve në mënyrë që votuesit e tjerë, anëtarët e këshillit të vendvotimit dhe përfaqësuesit e vëzhguesve të mos e shohin votuesin duke plotësuar fletën e votimit
- që askush t'i mos afrohet paravanit teksa votuesi është duke plotësuar fletëvotimin
- që anëtarët e këshillit të vendvotimit, votuesit e tjerë, përfaqësuesit e vëzhguesve ose cilido person tjetër të mos kenë mundësi t'i sugjerojnë votuesit se kë të votojë në vendvotim
- që një person të mos votojë në vend të personit tjetër

VEPRIMI I TETË HEDHJA E FLETËVOTIMEVE NË KUTITË PËRKATËSE TË VOTIMIT



Pasi ka plotësuar fletëvotimin për zgjedhjet parlamentare dhe fletëvotimin për zgjedhjet presidenciale, votuesi i palos ato dhe i hedh në kutitë përkatëse të votimit, dhe pastaj largohet nga vendvotimi.

Duke qenë se në votim më 3 prill 2022 në të gjitha vendvotimet do të gjenden nga dy kuti votimi (dhe në vendvotimet në 14 komuna dhe qytete në të cilat do të mbahen edhe zgjedhjet lokale do të ketë edhe nga tri kuti votimi), është shumë e rëndësishme që secila kuti të shënohet në mënyrë të përshtatshme, që votuesit të mos hedhin fletëvotimet në kutitë e gabuara.

SHËNIM:

Një anëtar i këshillit të vendvotimit është i detyruar të kujdeset që votuesit t'i hedhin fletëvotimet në kutitë përkatëse të votimit.

Është detyrë e këshillit të vendvotimit që, në rast të konstatimit ose dyshimit se ndonjë votues nuk e ka hedhur fletëvotimin e tij në kutinë e votimit para largimit nga vendvotimi, ta njoftojë policinë dhe komisionin zgjedhor lokal.

MBAJTJA E NJËKOHSHME E ZGJEDHJEVE LOKALE DHE PARLAMENTARE

Në rast se zgjedhjet parlamentare mbahen njëkohësisht me zgjedhjet lokale, votuesi, pasi nënshkruhet në dy ekstrakte të listës së votuesve për zgjedhjet parlamentare, është i detyruar t'i afrohet anëtarit të komisionit zgjedhor i cili është i ngarkuar me menaxhimin e ekstraktit të listës së votuesve për votim në zgjedhjet lokale. Ky anëtar i komisionit zgjedhor do ta përsërisë procedurën e kërkimit të emrit të votuesit në ekstrakt, duke rrethuar numrin rendor të emrit dhe mbiemrit të votuesit dhe duke ia mundësuar atij që të nënshkruhet në ekstrakt, ndërsa anëtari i fundit i komisionit zgjedhor, pas dorëzimit të fletëvotimeve për zgjedhjet parlamentare, do të dorëzojë edhe fletëvotimin për zgjedhjet lokale.

6. VOTIMI JASHTË VENDVOTIMIT

Ligji lejon mundësinë që votuesi të votojë jashtë vendvotimit në rast të sëmundjes së rëndë, moshës së shtyrë ose aftësive të kufizuara.

Në përputhje me sa më sipër, votimi jashtë vendvotimit nuk u lejohe personave të cilët nuk kanë mundësi të votojnë gjatë orarit të punës së vendvotimit për shkak të natyrës së punës që bëjnë.

Ligji parashikon që votimi jashtë vendvotimit mund të kryhet vetëm në **zonën** e cila mbulohet nga vendvotimi.

Gjithashtu, ligji parashikon që votuesit të cilët duan të votojnë por nuk kanë mundësi ta bëjnë në vendvotim, duhet të njoftojnë komisionin zgjedhor lokal **jo më herët se 72 orë para ditës së votimit dhe jo më vonë se në orën 11.00 të ditës së votimit**, ose këshillin e vendvotimit në ditën e votimit, **jo më vonë se në orën 11**.

Komisioni zgjedhor lokal mban evidencën e njoftimeve të marra nga votuesit të cilët duan të votojnë jashtë vendvotimit dhe është i detyruar t'i njoftojë këshillat e vendvotimit mbi to.

Këshilli i vendvotimit është i detyruar të kontrollojë nëse të gjithë votuesit që kanë aplikuar për votim jashtë vendvotimit:

- janë të regjistruar në të gjitha ekstraktet nga lista e votuesve
- gjenden në zonën e cila mbulohet nga vendvotimi

! VËMENDJE:

Gjatë verifikimit nëse votuesi është i regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve, këshilli i vendvotimit **NUK DUHET** të rrethojë numrin me të cilin është regjistruar votuesi në ekstrakt dhe **NUK DUHET** të bëjë shënimin se votuesi është duke votuar jashtë vendvotimit. Rrethimi i numrit rendor në ekstraktet nga lista e votuesve dhe bërja e shënimit se votuesi është duke votuar jashtë vendvotimit kryhen vetëm pasi votuesi voton jashtë vendvotimit, ose pasi të kthehet komisioneri i këshillit të vendvotimit nga votuesi dhe pasi të verifikohet se votuesi i ka nënshkruar vërtetimet për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit.

Para se të shkohet te votuesi, plotësohen veç e veç vërtetimet për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit për të dy proceset zgjedhore.

ПОТВРДА

О ИЗБОРНОМ ПРАВУ ЗА ГЛАСАЊЕ ВАН БИРАЧКОГ МЕСТА НА ИЗБОРИМА ЗА НАРОДНЕ ПОСЛАНИКЕ

Потврђује се да је

_____ (име и презиме)

_____ (ЈМБГ)

са пребивалиштем у

_____ (место)

_____ (адреса пребивалишта)

уписан у извод из бирачког списка за гласање

на изборима за народне посланике

расписаним за 3. април 2022. године,

на бирачком месту број _____,

у општини/граду _____ (назив општине / града)

под редним бројем _____ и да има изборно право.

У _____ 2022. године
(место) (дан и месеца)

БИРАЧ

ПРЕДСЕДНИК БИРАЧКОГ ОДБОРА

_____ (потпис)

_____ (потпис)

_____ (име и презиме)

_____ (име и презиме)

НАПОМЕНА: Потврду попуњава бирачки одбор и потписује председник бирачког одбора пре одласка повереника бирачког одбора код бирача који гласа ван бирачког места. Бирач обавезно потписује потврду, коју повереници бирачког одбора враћају бирачком одбору. **Ако ова потврда није потписана од стране бирача, сматраће се да бирач није гласао.**

ПОТВРДА

О ИЗБОРНОМ ПРАВУ ЗА ГЛАСАЊЕ ВАН БИРАЧКОГ МЕСТА
НА ИЗБОРИМА ЗА ПРЕДСЕДНИКА РЕПУБЛИКЕ

Потврђује се да је

(име и презиме)

(ЈМБГ)

са пребивалиштем у

(место)

(адреса пребивалишта)

уписан у извод из бирачког списка за гласање
на изборима за председника Републике
расписаним за 3. април 2022. године,
на бирачком месту број _____,
у општини/граду _____
(назив општине / града)

под редним бројем _____ и да има изборно право.

У _____ 2022. године
(место) (дан и месец)

БИРАЧ	ПРЕДСЕДНИК БИРАЧКОГ ОДБОРА
_____	_____
(потпис)	(потпис)
_____	_____
(име и презиме)	(име и презиме)

НАПОМЕНА: Потврду попуњава бирачки одбор и потписује председник бирачког одбора пре одласка повереника бирачког одбора код бирача који гласа ван бирачког места. Бирач обавезно потписује потврду, коју повереници бирачког одбора враћају бирачком одбору. **Ако ова потврда није потписана од стране бирача, сматраће се да бирач није гласао.**

Për nevojat e zbatimit të votimit jashtë vendvotimit, kryetari i këshillit të vendvotimit dhe komisionerët e këshillit të vendvotimit përgatisin materialet në vijim:

- Listën përmbledhëse zgjedhore

- Listën e kandidatëve për zgjedhjen e presidentit të Republikës
- Llambën UV
- sprej për shënimin e gishtit të votuesit
- dy vërtetime të plotësuara për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit (nga një vërtetim për çdo zgjedhje), për të gjithë votuesit të cilët duhet të votojnë jashtë vendvotimit
- numrin e duhur të fletëvotimeve (për të dy proceset zgjedhore) për të gjithë votuesit të cilët duhet të votojnë jashtë vendvotimit
- Numrin e duhur të zarfeve (për të dy proceset zgjedhore) në të cilat votuesit të cilët votojnë jashtë vendvotimit duhet të vendosin fletëvotimet e tyre pasi të votojnë (zarfet e ndara)
- Numrin e duhur të zarfeve (për të dy proceset zgjedhore) në të cilat komisionerët e këshillit të vendvotimit duhet të vendosin një zarf të veçantë me fletëvotimin dhe vërtetimin e nënshkruar të së drejtës zgjedhore për votim jashtë vendvotimit (zarfet zyrtare)
- pajisje shkrimi dhe stikerat për vulosjen e zarfeve

Sic u përmend, votimi jashtë vendvotimit zbatohet nga komisionerët e këshillit të vendvotimit - tre anëtarë ose zëvendës anëtarë të këshillit të vendvotimit të emëruar me propozim të propozuesve të ndryshëm të autorizuar nga të cilët të paktën njëri komisionet duhet të jetë përfaqësues i listës zgjedhore të opozitës.

SHËNIM:

Nëse numri i lartë i votuesve kanë aplikuar për votim jashtë vendvotimit, këshilli i vendvotimit mund të dakordohet që të përcaktohen disa ekipe për zbatimin e votimit jashtë vendvotimit, në mënyrë që t'u sigurohet votimi të gjithë votuesve të cilët kanë aplikuar. Në këtë rast, këshilli i vendvotimit do të kërkojë nga komisioni zgjedhor lokal sprajet, llambat UV, listat përmbledhëse zgjedhore dhe listat e kandidatëve për zgjedhjen e presidentit të Republikës.

SHËNIM:

Përfaqësuesit e akredituar të vëzhguesve vendas dhe të huaj kanë të drejtë të jenë të pranishëm në votim jashtë vendvotimit.

Pas mbërritjes te votuesi, së pari verifikohet identiteti i tij dhe më pas kontrollohet me llambë UV a ka votuar tashmë ndoshta.

Komisionerët e këshillit të vendvotimit e verifikojnë identitetin e votuesit pasi votuesi ua tregon dokumentin e vlefshëm të identifikimit (letërnjoftimin ose pasaportën). Komisionerët e këshillit të vendvotimit duhet të krahasojnë të dhënat e votuesit nga dokumenti i identifikimit me të dhënat e regjistruara në vërtetimin për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit, përkatësisht duhet ta verifikojnë nëse emri dhe mbiemri i votuesit dhe numri i tij unik i identifikimit janë identikë në të dy dokumente.

Votuesit të cilit i ka skaduar letërnjoftimi ose pasaporta duhet t'i lejohet votimi vetëm me kushtin që votuesi të paraqesë vërtetimin se ka paraqitur kërkesën për lëshimin e letërnjoftimit ose pasaportës së re në Ministrinë e Punëve të Jashtme.

Në rast se votuesi ka një dokument të vlefshëm i cili përmban një mbiemër tjetër nga mbiemri i shkruar në vërtetimin për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit, komisionerët e këshillit të vendvotimit duhet t'i mundësojnë këtij votuesi që të votojë, pavarësisht kësaj rrethane, por me kusht që të mund të vërtetohet se bëhet fjalë për të njëjtin person në bazë të fotografisë së votuesit dhe numrit unik të identifikimit në dokument.

Pasi të përcaktohet identiteti i votuesit dhe pasi të kontrollohet me llambën UV se nuk ka votuar tashmë, votuesit i jepen vërtetimet e plotësuara për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit për të dy proceset zgjedhore, në mënyrë që votuesi i t'i nënshkruajë ato.

Komisionerët e këshillit të vendvotimit duhet DETYRIMISHT t'i tërheqin vëmendjen votuesit se duhet të nënshkruhen të dy vërtetime për të drejtën zgjedhore dhe se çdo fletëvotim të vendoset në zarf të veçantë, dhe jo të gjitha në një zarf.

Kur bëhet fjalë te nënshkrimi i votuesve me aftësi të kufizuar në vërtetimet për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit, zbatohen rregullat për nënshkrimin e votuesve te ekstrakti nga lista e votuesve në vendvotim.

! VËMENDJE:

Para shënimit të gishtit të votuesit me sprej dhe para dorëzimit të materialit zgjedhor, komisionerët e këshillit të vendvotimit duhet të kontrollojnë detyrimisht nëse votuesi i ka nënshkruar vërtetimet për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit, si dhe nëse këto vërtetime gjenden në zarfet zyrtare, **sepse nënshkrimi në këto vërtetime e zëvendëson nënshkrimin në ekstraktet nga listat e votuesve, dhe një vërtetim i panënshkruar, sipas ligjit, do të thotë se votuesi nuk ka votuar dhe se zarfi i tij me fletëvotimin nuk hapet, por vendoset në një thes me materialin zgjedhor bashkë me fletëvotimet e papërdorura.**


Kur votuesi t'i nënshkruajë të dy vërtetime për të drejtën zgjedhore dhe kur t'ua dorëzojë ato komisionerëve të këshillit të vendvotimit, votuesit i shënohet me sprej gishti tregues i dorës së djathtë, ose gishti tjetër përkatës të dorës dhe i dorëzohen materialet zgjedhore si më poshtë:

- dy fletëvotime (njëri për zgjedhjet parlamentare dhe tjetri për ato presidenciale);
- lista përmbledhëse zgjedhore;
- lista e kandidatëve për zgjedhjen e presidentit të Republikës;
- dy zarfe të veçanta në të cilat votuesi do t'i vendosë fletëvotimet pasi të votojë.

SHËNIM:

Nëse votuesi refuzon, ose nuk lejon që t'i shënohet gishti me sprej, komisionerët e këshillit të vendvotimit nuk do t'i lejojnë që të votojë.

Më pas, votuesit i shpjegohet procedura e votimit dhe i theksohet se pasi t'i plotësoj fletëvotimet, duhet t'i palosë ato dhe t'i vendosë të palosur në zarfe të veçanta të cilat i janë dhënë.




Pasi të kryhen veprimet e mësipërme, komisionerët nga këshilli i vendvotimit largohen nga ambienti në të cilin votuesi duhet të votojë.

SHËNIM:

Nëse votuesi nuk është në gjendje të plotësojë fletëvotimin (si pasojë e analfabetizmit, problemeve të shikimit, aftësive të kufizuara ose diçkaje tjetër), ai mund të votojë me ndihmën e ndihmësit, njësoj si personat analfabetë ose me shikim të dëmtuar, si dhe personat me aftësi të kufizuara kur votojnë në vendvotim.

Pasi të votojë, komisionerët e këshillit të vendvotimit kthehen në ambientin ku ka votuar votuesi dhe marrin zarfet në të cilat votuesi i ka vendosur fletëvotimet e tij, dhe ato vulosen me ngjitëse në prani të votuesit.

Më pas, në një zarf zyrtar vendosen vërtetimi i nënshkruar për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit në zgjedhjet për deputetët popullorë dhe një zarf e veçantë e vulosur në të cilin gjendet fletëvotimi për zgjedhjet për deputetët popullorë kurse në zarfin tjetër zyrtar vendosen vërtetimi i nënshkruar për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit në zgjedhjet për presidentin e Republikës dhe një zarf e veçantë e vulosur në të cilën gjendet fletëvotimi për zgjedhjet për presidentin e Republikës, dhe pas kësaj votimi konsiderohet i kryer.



Pas kthimit në vendvotim, komisionerët e këshillit të vendvotimit menjëherë ia dorëzojnë kryetarit të këshillit të vendvotimit zarfet zyrtare, të cilat kryetari i këshillit të vendvotimit i hap dhe kontrollon nëse në to gjenden vërtetimet për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit dhe nëse ato janë nënshkruar nga ana e votuesit.

Vetëm pasi të vërtetohet se zarfi zyrtar përmban vërtetimin për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit dhe se vërtetimi është i nënshkruar nga ana e votuesit, rrethohet numri rendor me të cilin është regjistruar votuesi në ekstraktin përkatës nga lista e votuesve **dhe te vendi për nënshkrimin e votuesit në ekstraktin nga lista e votuesve vihet shënimi se votuesi ka votuar jashtë vendvotimit** (“votoi jashtë q.v.”).

Më pas, kryetari i këshillit të vendvotimit e hap zarfin e veçantë të vulosur dhe e nxjerr fletëvotimin e palosur dhe e hedh atë në kutinë përkatëse të votimit, duke u kujdesur që të mos shihet se kujt ia ka dhënë votën votuesi.

! VËMENDJE:

NËSE VËRTETIMI PËR TË DREJTËN ZGJEDHORE PËR VOTIM JASHTË VENDVOTIMIT ËSHTË I NËNSHKRUAR, këshilli i vendvotimit nuk duhet të harrojë të bëjë shënimin në ekstraktin përkatës nga lista e votuesve se ky votues ka votuar jashtë vendvotimit. Në të kundërtën, do të kenë probleme tek verifikimi i rezultateve të votimit dhe numrit të votuesve të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjet!

! VËMENDJE:

NËSE VËRTETIMI PËR TË DREJTËN ZGJEDHORE NUK ËSHTË I NËNSHKRUAR, NUK DUHET të bëhet shënim në

ekstraktin nga lista e votuesve se votuesi ka votuar jashtë vendvotimit, ndërsa zarfi zyrtar në të cilin gjendet fletëvotimi NUK HAPET, por pas votimit i jepet i vulosur komisionit zgjedhor lokal në një zarf me fletëvotimet e papërdorura!

Në rast se është **nënshkruar vetëm një nga vërtetimet për të drejtën zgjedhore**, bëhet shënimi se votuesi ka votuar jashtë vendvotimit vetëm në atë ekstrakt nga lista e votuesve për të cilin është nënshkruar vërtetimi dhe vetëm ky fletëvotim hidhet në kutinë përkatëse të votimit.

Këshilli i vendvotimit shënon në Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit (për të dy proceset zgjedhore):

- numrin e votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit
- numrin e vërtetimeve të plotësuara dhe të nënshkuara për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit

Pas votimit, këshilli i vendvotimit, bashkë me materialet e tjera zgjedhore, në një zarf të veçantë dorëzon vërtetimet **E NËNSHKRUARA** dhe **TË PANËNSHKRUARA** për të drejtën zgjedhore të të gjithë votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit.

MBAJTJA E NJËKOHSHME E ZGJEDHJEVE LOKALE DHE PARLAMENTARE

Nëse njëkohësisht me zgjedhjet parlamentare mbahen edhe zgjedhjet lokale, këshilli i vendvotimit e kontrollon detyrimisht nëse votuesi është regjistruar **NË TË GJITHA EKSTRAKTET NGA LISTA E VOTUESVE.**

! VËMENDJE:

Nëse njëkohësisht me zgjedhjet parlamentare mbahen edhe zgjedhjet lokale, dhe votuesi përveç së drejtës për të votuar në zgjedhjet parlamentare ka të drejtë të votojë edhe në zgjedhjet lokale, këshilli i vendvotimit duhet të plotësojë tri vërtetime për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit, pra një vërtetim të veçantë për çdo palë zgjedhjesh dhe **votuesi është i detyruar t'i nënshkruajë të tri vërtetime, sepse, ju kujtojmë, nënshkrimi i votuesit në këto vërtetime e zëvendëson nënshkrimin e votuesit në ekstraktet nga lista e votuesve.**

! VËMENDJE E VEÇANTË:

Nëse votuesi ka votuar edhe në zgjedhjet lokale, pas kthimit në vendvotim duhet të kontrollohet nëse votuesi e ka nënshkruar edhe vërtetimin për të drejtën zgjedhore për votim edhe në zgjedhjet lokale!

7. KOMUNIKIMI DHE MËNYRA E OFRIMIT TË MBËSHTETJES VOTUESVE TË CILËT JANË ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Anëtarët e këshillit të vendvotimit e kanë detyrë dhe përgjegjësi t'u ofrojnë mbështetje të gjithë votuesve gjatë zgjedhjeve.

Disave, sidomos votuesve me aftësi të kufizuar, gjatë votimit ndoshta do t'u duhet ndihma nga anëtarët e këshillit të vendvotimit.

Në kuadër të këtij kapitulli do t'ju tregojmë disa këshilla të dobishme për t'u mundësuar qasjen në votim votuesve të cilët janë me aftësi të kufizuar.

Fillimisht, rëndësi ka të dihet se jo të gjithë personat me aftësi të kufizuar kanë një invaliditet të dukshëm, sepse këto persona ndonjëherë mund të kenë ndonjë invaliditet jo të dukshëm. Prandaj, anëtarët e këshillit të vendvotimit duhet ta kenë parasysh se duhet të sillen me vëmendje ndaj çdo votuesi, dhe t'i ofrojnë ndihmë çdo votuesi i cili e kërkon atë, edhe pse invaliditeti i tij/saj mund të mos jetë i dukshëm.

7.1. QASSHMËRIA E VENDVOTIMIT

Komisioni zgjedhor i Republikës, me Vendimin për vlerësimin e qasshmërisë së vendvotimit në Republikën e Serbisë nr.: 013-99/19 të datës 20 dhjetor 2019 ka rregulluar mënyrën e vlerësimit të qasshmërisë së vendvotimit në Republikën e Serbisë.

Qëllimi i vlerësimit të qasshmërisë është përmirësimi i kushteve në të cilat votuesit e realizojnë të drejtën e tyre zgjedhore në vendvotimet, me një reflektim të veçantë të përmirësimi i pozitës së personave me aftësi të kufizuar në procesin zgjedhor.

Vlerësimi i qasshmerisë kryhet nga ana e administratës komunale/së qytetit, ose administratës së komunave urbane të qytetit të Beogradit.

Gjatë vlerësimit të qasshmërisë së vendvotimeve, ndër të tjerave vlerësohet detyrimisht edhe ambienti në të cilin gjendet vendvotimi, dera hyrëse e vendvotimit, lëvizja brenda objektit dhe format e informacioneve si dhe komunikimi me votuesit.

Vlerësimin e qasshmerisë së vendvotimeve në Republikën e Serbisë mund ta gjeni te faqja zyrtare e KQY-së në adresën: <https://www.rik.parlament.gov.rs/tekst/3194/pristupacnost-birackih-mesta.php>

7.2. RREGULLIMI I VENDVOTIMIT NË MËNYRË QË TË PËRSHTATET ME NEVOJAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Para se të hapet vendvotimi, ai duhet të rregullohet në mënyrë që të përshtatet me nevojat e votuesve me aftësi të kufizuara.

Për këtë qëllim, këshilli i vendvotimit e kontrollon me kujdes ambientin dhe:

1. nëse ambienti është mjaft i ndriçuar në mënyrë që votuesit të mund të shohin fytyrën e anëtarit të këshillit të vendvotimit me të cilin janë duke biseduar dhe të lexojnë fletëvotimet e tyre pa problem;

2. Nëse ambienti nuk është mjaft i ndriçuar, duhet të kujdesemi për ndriçimin (p.sh. ta ndezim dritën, të hapim perdet e dritareve, të ngremë roletat etj.)

3. A është hapur mjaftueshëm dera hyrëse e ambientit, në mënyrë që votuesit me karrocë, paterica, shkop ose mbështetëse mund të hyjnë lehtë në ambient;

SHËNIM:

Nëse dera nuk mund të rrijë e hapur vazhdimisht, është e domosdoshme që të kujdesemi që dera e vendvotimit të hapet në momentin kur të vijë një votues me aftësi të kufizuara, me karrocë, paterica, shkop ose mbështetëse.

4. A ka elemente të pozicionuara ulët nëpër mure ose në tavan, të cilat do të mund të përbënin pengesë për votuesit e verbër ose me shikim të dëmtuar gjatë hyrjes ose lëvizjes nëpër vendvotim;

Nëse ka elemente të tilla, anëtarët e këshillit të vendvotimit janë të detyruar t'i heqin ato ose, gjatë hyrjes dhe lëvizjes së votuesve të verbër ose me shikim të dëmtuar, të mundësojnë që këto elemente të mos i pengojnë ata.

5. A ka letra dhe stilolapsa në dispozicion të cilat mund të përdoren nëse është e nevojshme të shkruhet ose të vizatohet ndonjë udhëzim për votuesit;

SHËNIM:

Letra dhe stilolapsa të cilat janë pjesa e domosdoshme e materialit që merr këshilli i vendvotimit, duhet të jenë në dispozicion të anëtarëve të këshillit të vendvotimit, nëse ka nevojë t'u shkruhen ose vizatohen sqarimet votuesve me aftësi të kufizuar.

6. A ka hapësirë në vendvotim për votuesit të cilët përdorin karrocën, në mënyrë që të lëvizin në mënyrë të papenguar nëpër ambient;

SHËNIM:

Nëse në ambientin e vendvotimit nuk ka mjaftueshëm hapësirë për lëvizjen e votuesve të cilët përdorin karrocën, është e nevojshme që këshilli i vendvotimit t'i zhvendosë karriget dhe sendet e tjera të panevojshme nga vendvotimi në mënyrë që votuesit me aftësi të kufizuara t'i kryejnë të gjitha veprimet dhe të lëvizin në mënyrë të papenguar brenda vendvotimit.

7. Nëse kutitë e votimit janë vendosur në lartësinë e duhur në mënyrë që edhe votuesit me aftësi të kufizuara të mund të hedhin fletëvotimet e tyre në to;

SHËNIM:

Nëse kutitë e votimit nuk janë vendosur në një lartësi të tillë që një votues me aftësi të kufizuara ta ketë të lehtë të hedhë fletëvotimin në të, këshilli i vendvotimit duhet të kujdeset që këtij votuesi t'i ofrohet ndihma në mënyrë që të hedhë fletëvotimin e tij në kutinë përkatëse të votimit.

! VËMENDJE:

Ambienti në të cilin gjendet vendvotimi duhet të jetë i qasshëm për të gjithë votuesit, dhe sidomos ata votues të cilët janë persona me aftësi të kufizuara.

7.3. TERMINOLOGJIA E PËRDORUR NË KOMUNIKIM ME PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUAR

- Person me aftësi të kufizuar
- Person i verbër ose me shikim të dëmtuar
- Person i shurdhët ose me dëgjim të dëmtuar
- Përdorues i karrocës

7.4. E DREJTA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR PËR TË VOTUAR ME NDIHMËN E NDIHMËSIT

Një votues i cili nuk ka mundësi të votojë personalisht në vendvotim, ka të drejtë të paraqitet në shoqëri të një personi i cili do ta kryejë votimin në vend të tij, në mënyrën e caktuar nga votuesi (p.sh. Paraqitja e dokumenteve personale dhe të thirrjes për votim, nënshkrimi në ekstraktet nga lista e votuesve ose përdorimi i vulës me nënshkrim të gdhendur (faksimil) ose të vulës e cila përmban të dhënat për identitetin personal të votuesit, plotësimi i fletëvotimit ashtu si t'i thotë votuesi etj.).

Në vend të votuesit i cili nuk ka mundësi të nënshkruhet vet, ekstraktin nga lista e votuesve e nënshkruan ndihmësi i tij me emrin dhe mbiemrin e vet.

7.5. REKOMANDIMET E PËRGJITHSHME PËR OFRIMIN E NDIHMËS VOTUESVE TË CILËT JANË PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Anëtarët e këshillit të vendvotimit duhet:

- të pyesin çdo votues nëse i duhet ndihma;
- të vlerësojnë votuesit të cilët janë persona me aftësi të kufizuar dhe të cilët kanë marrë me vete një ndihmës i cili do ta kryejë votimin në vend të tij, ashtu si t'i thotë votuesi;
- t'u drejtohen votuesve të cilët janë persona me aftësi të kufizuar, dhe jo ndihmësve të tyre;
- të tregojnë durim kur janë duke ua sqaruar votuesve procedurën e votimit.

7.5.1. PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR FIZIKE

Person me aftësi të kufizuar fizike mund të ketë vështirësi në ecje ose në ngjitjen e shkallëve dhe mund të përdorë karrocën ose mjetet e tjera ndihmëse (paterica, shkop ose mbështetëse).

MËNYRA E KOMUNIKIMIT DHE OFRIMI I NDIHMËS VOTUESVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR FIZIKE

Nëse këshilli i vendvotimit vë re se një votues me aftësi të kufizuar fizike ka vështirësi gjatë hyrjes në ambientin e vendvotimit ose gjatë hapjes së derës, duhet të ofrojnë ndihmë. Gjithashtu, votuesi mund të kërkojë të mbështetet te anëtari i këshillit të vendvotimit ose të kërkojë ndihmë nga ai që të hyjë në ambient.

Anëtarët e këshillit të vendvotimit duhet t'u kushtojnë vëmendje gjërave në vijim nëse paraqitet në vendvotim një votues i cili përdor karrocën:

- të mos mbështeten te karroca dhe të mos e prekin pa lejen e votuesit,
- Nëse flasin më gjatë se një minutë me votuesin i cili përdor karrocën, duhet të ulen në mënyrë që sytë t'i kenë në një nivel me sytë e votuesit.

7.5.2. PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR SHQISORE

Persona me aftësi të kufizuar shqisore janë:

- Personat e verbër ose me shikim të dëmtuar;
- Personat e shurdhët ose me dëgjim të dëmtuar.

MËNYRA E KOMUNIKIMIT DHE OFRIMI I NDIHMËS VOTUESVE TË VERBËR OSE ME SHIKIM TË DËMTUAR

Kur një votues i verbër ose me shikim të dëmtuar hyn vet në vendvotim ose me një ndihmës, këshilli i vendvotimit është i detyruar të prezantohet.

Nëse është e nevojshme që t'i tërhiqet vëmendja një votuesi të verbër ose me shikim të dëmtuar, një anëtar i këshillit të vendvotimit duhet ta përhëndesë ose eventualisht t'ia prekë supin lehtë.

Anëtari i këshillit të vendvotimit është i detyruar t'i ofrojë ndihmë një votuesi të verbër ose me shikim të dëmtuar si dhe ndihmësit të tij, duke e udhëzuar deri te vendet në të cilat kryhen veprime në procedurën e votimit (vendi ku kryhet kontroll me llambën UV, vendi ku verifikohet identiteti i votuesit, vendi në të cilin vërtetohet nëse votuesi është i regjistruar në ekstraktet nga lista e votuesve, vendi në të cilin votuesi nënshkruhet vet ose me ndihmën e ndihmësit në ekstraktin nga lista e votuesve, vendi mbrapa paravanit të votimit dhe vendi në të cilin gjenden kutitë e votimit).

MËNYRA E KOMUNIKIMIT DHE OFRIMI I NDIHMËS VOTUESVE TË SHURDHËT OSE ME DËGJIM TË DËMTUAR

Nëse është e nevojshme që anëtari i këshillit të vendvotimit të tërheqë vëmendjen e një votuesi të shurdhët ose me dëgjim të dëmtuar, mjafton t'i bëjë me dore lehtëshëm ose ta prekë votuesin te supi.

Anëtari i këshillit të vendvotimit e shikon votuesin gjithmonë në fytyrë dhe i flet ngadalë dhe në mënyrë të kuptueshme.

Nëse është e nevojshme, anëtari i këshillit të vendvotimit mund të shkruajë ose të vizatojë sqarimin.

Anëtari i këshillit të vendvotimit është i detyruar të flasë drejtpërdrejtë me votuesin, madje edhe nëse është në praninë e ndihmësit ose përkthyesit për gjuhën e shenjave.

Nëse votuesi nuk e kupton ose nuk e dëgjon një fjalë të caktuar që ka shqiptuar anëtari i këshillit të vendvotimit, anëtari duhet të përpiqet të përdorë ndonjë fjalë tjetër.

7.5.3. PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUAR INTELEKTUALE

Persona me aftësi të kufizuar intelektuale mund të kenë vështirësi në përballimin me ambientin, komunikimin ose të kuptuarit e mesazheve të përbëra ose të reja. Ky, për shembull, mund të jetë rasti te personat me çrregullimet e spektrit të autizmit ose me sindromën Down.

MËNYRA E KOMUNIKIMIT DHE OFRIMI I NDIHMËS VOTUESVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR INTELEKTUALE

Një votues me aftësi të kufizuar intelektuale mund të ketë një ndihmës.

Kur anëtari i këshillit të vendvotimit bisedon me votuesin me aftësi të kufizuar intelektuale, e shikon drejtpërdrejt dhe flet në mënyrë të ngadaltë dhe të kuptueshme.

Anëtari i këshillit të vendvotimit përdor shprehje të thjeshta dhe të qarta në mënyrë që t'i shpjegojë procedurën e votimit.

Anëtari i vendvotimit duhet të bisedojë si me çdo votues tjetër dhe të jetë i gatshëm që t'i shkruajë ose vizatojë një sqarim votuesit për ta ndihmuar që ta kuptojë procedurën e votimit.

Anëtari i këshillit të vendvotimit duhet të shmangë zhurmën dhe tonin e lartë sepse personat me aftësi të kufizuar intelektuale mund të jenë veçanërisht të ndjeshëm ndaj kësaj.

! VËMENDJE:

Një votues me aftësi të kufizuar mund të votojë jashtë vendvotimit. Komisionerët e këshillit të vendvotimit të cilët zbatojnë votimin jashtë vendvotimeve, në komunikim me votuesin i cili është person me aftësi të kufizuar, zbatojnë të gjitha rekomandimet e lartpërmendura për votim jashtë vendvotimit.

8. MBAJTJA E RENDIT NË VENDVOTIM

Këshillat e vendvotimit janë të detyruar që të kujdesen për rendin në vendvotim.

Në lidhje ke këtë, duhet të kemi parasysh se në vendvotim mund të jenë të pranishëm vetëm ata persona të cilët kanë të drejtat dhe detyrat në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve. Këta janë:

- anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këshillit të vendvotimit
- anëtarët dhe zëvendësanëtarët e komisionit zgjedhor lokal
- anëtarët dhe zëvendësanëtarët e KQZ-së
- votuesit
- përfaqësuesit e akredituar të vëzhguesve
- përfaqësuesit e medias

Anëtarët e këshillit të vendvotimit, komisionit zgjedhor lokal dhe KQZ-së mund të jenë të pranishëm në vendvotim gjatë gjithë kohës.

Votuesi mund të jetë i pranishëm në vendvotim vetëm për aq kohë sa i duhet për të kryer procedurën e votimit. Pasi ta kryejë votimin, votuesi është i detyruar të largohet nga vendvotimi.

Tashmë u përmend që në ambientin në të cilin kryhet votimi mund të jenë të pranishëm vetëm aq votues sa ka paravane të votimit.

Personi të cilit këshilli i vendvotimit nuk i ka lejuar të votojë (sepse nuk është i regjistruar në ekstraktet e listës së votuesve e as në listën e ndryshimeve të mëvonshme në listën e votuesve, ose nuk mund të dëshmojë identitetin e tij ose kontrolli me llambën UV ka treguar se personi ka votuar tashmë) është i detyruar të largohet menjëherë nga vendvotimi pasi t'i komunikojë këshilli vendvotimit se nuk mund të votojë.

Përfaqësuesit e vëzhguesve janë personat të cilave KQZ u ka lejuar ndjekjen e zgjedhjeve dhe ata mund të jenë të pranishëm në vendvotim vetëm nëse zotërojnë një akreditim të KQZ-së.



VËZHUESIT VENDORË



VËZHUESIT NDËRKOMBËTARË

Përfaqësuesit e vëzhguesve kanë të drejtë të ndjekin çdo fazë të punës së këshillit të vendvotimit si dhe çdo veprim zgjedhor, që do të thotë se ata mund të ndjekin punën e këshillit të vendvotimit që nga dorëzimi i materialit zgjedhor para votimit.

Për sa i përket ditës së votimit, përfaqësuesit e vëzhguesve mund të vijnë në vendvotim gjatë mbledhjes së anëtarëve të këshillit të vendvotimit, pra edhe para hapjes së vendvotimit, dhe mund të rrinë në vendvotim deri në fund të punës së këshillit të vendvotimit, duke përfshirë edhe vëzhgimin e punës së këshillit të vendvotimit gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor pranë komisionit zgjedhor lokal pas votimit në ndërtesën e komunës/qytetit.

SHËNIM:

Sipas ligjit, një përfaqësues i vëzhguesit të huaj mund të vijë në vendvotim i shoqëruar nga përkthyesi i akredituar, por përkthyesi nuk duhet të jetë i pranishëm në vendvotim pa përfaqësuesin e vëzhguesit të cilin e shoqëron.

Për sa i përket përfaqësuesve të vëzhguesve vendas, një shoqatë mund të aplikojë me disa përfaqësues, por në vendvotim mund të jetë i pranishëm vetëm njëri prej tyre, që do të thotë se ata mund të ndërrohen gjatë votimit.

Përfaqësuesit e vëzhguesve janë të detyruar t'i mbajnë akreditimet e lëshuara nga KQZ në vend të dukshëm gjatë gjithë kohës së kaluar në vendvotim.

Prania e përfaqësuesit të vëzhguesit në vendvotim konstatohet në Procesverbalin për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit, i cili përveç të dhënave të përfaqësuesve të vëzhguesve të cilët kanë ndjekur punën e këshillit të vendvotimit, përmban edhe vërejtjet e tyre të mundshme, **të cilat vëzhguesit i shënojnë vetë në Procesverbalin për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit, dhe më pas nënshkruhen në Procesverbal.**

Këshilli i vendvotimit është i autorizuar që të largojë përfaqësuesin e vëzhguesit të vendvotimit nëse:

- nuk u përmbahet rregullave për mbajtjen e rendit në vendvotim
- nëse përdor telefonin celular në vendvotim ose mjetet e tjera të lidhjes dhe komunikimit
- pengon punën e këshillit të vendvotimit

Në rast se këshilli i vendvotimit e largon përfaqësuesin e vëzhguesve nga vendvotimi, është i detyruar të njoftojë menjëherë komisionin zgjedhor lokal, ndërsa këshilli i vendvotimit jashtë vendit e njofton KQZ-në.

Përfaqësuesit e mediave mund të vijnë në vendvotim për të përgatitur raport mbi ecurinë e votimit, duke lajmëruar paraprakisht komisionin zgjedhor lokal ose koordinatoren e KQZ-së, dhe përveç kësaj nuk duhet të rrinë në vendvotim.

Si shkelje e rendit në vendvotim cilësohen të gjitha veprimet të cilat cenojnë anonimitetin e votimit (për shembull, që dikush të rrijë afër

paravanit dhe të vëzhgojë se si votuesit i plotësojnë fletëvotimet) ose ndikojnë në vendimin e votuesit se kë do të votojë (për shembull, bërja e propagandës në vendvotim ose theksimi i simboleve të partive politike ose të materialit tjetër propagandues në vendvotim ose drejtpërdrejt para vendvotimit.)

Përveç kësaj, rendi në vendvotim konsiderohet i shkelur sidomos kur në vendvotim ose drejtpërdrejt para vendvotimit:

- rrinë persona të cilët nuk kanë të drejtë e as detyrë në lidhje me zbatimin e zgjedhjeve
- incizojnë dhe fotografojnë ngjarjet në vendvotim në mënyrë të paautorizuar
- duke përdorur telefonat celularë ose mjetet e tjera të lidhjes në mënyrë të paautorizuar japin njoftimet për ngjarjet në vendvotim, dhe sidomos për identitetin e personave të cilët kanë dalë ose nuk kanë dalë në zgjedhjet
- bëhen listat e votuesve të cilët kanë dalë ose nuk kanë dalë në zgjedhjet jashtë evidencës zyrtare në ekstraktin nga lista e votuesve
- theksohen simbolet e partive politike, paraqitësve të listave zgjedhore dhe propozuesve të kandidatëve për presidentin e Republikës, si dhe materialet e tjera zgjedhore propagandistike.

Me qëllim të mbajtjes së rendit, vendvotimi nënkupton ambientin në të cilin kryhet votimi, dhe nëse në njërin objekt gjenden disa ambiente votimi, i gjithë objekti konsiderohet vendvotim.

! VËMENDJE:

Në vendvotim lejohet me Ligj shënimi i vizave në një letër të veçante, si evidencë për pjesëmarrjen e votuesve. Kjo vlen në veçanti për ato vendvotime të cilat përcaktohen që të dërgojnë raportet për pjesëmarrjen e votuesve gjatë zgjedhjeve.

Në rast se mbahet evidenca për pjesëmarrjen në një vendvotim të caktuar, të dhënat për numrin e votuesve të cilët kanë dalë në zgjedhjet duhet të jenë në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit të vendvotimit.

Nëse në vendvotim ndodh ndonjë shkelje rendi, është detyrë e këshillit të vendvotimit që ta rivendosë rendin, me të drejtën e ndërprerjes së votimit deri sa të vendoset rendi.

Në rast të ndërprerjes së votimit, këshilli i vendvotimit është i detyruar të shënojë në Procesverbalin për punën e këshillit të vendvotimit arsyen dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes - pika 8.1 dhe 8.2 të Procesverbalit.

Nëse ndërprerja e votimit ka zgjatur më shumë se një orë, votimit zgjatet për aq sa ka zgjatur ndërprerja. Për shembull, nëse votimi është ndërprerë në 13:30 dhe ka vazhduar në 14:55, vendvotimi duhet të jetë i hapur deri në orën 21:45.

Ky rregull gjithashtu vlen në rastin kur hapja e vendvotimit shtyhet për më shumë se një orë, kështu që edhe votimi zgjatet për aq kohë sa është shtyrë hapja e vendvotimit.

Nëse ndërprerja ka zgjatur më pak se një orë, votimi nuk zgjatet.

Pjesëtarët e policisë dhe milicisë komunale në detyrë mund të hyjnë në vendvotim vetëm me thirrjen e kryetarit të këshillit të vendvotimit, nëse janë shkelur rendi dhe qetësia në vendvotim.

Ekskluzivisht, policët dhe milicionerët komunalë në uniformë mund të hyjnë në vendvotim në të cilin janë regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve për të votuar, me kushtin që të mos mbajnë armë ose mjetet e tjera e përdorimit të forcës.

MBAJTJA E NJËKOHSHME E ZGJEDHJEVE LOKALE PËR ANSAMBLISTËT E ANSAMBLESE SË QYTETIT TË BEOGRADIT

Në vendvotimet në territorin e Qytetit të Beogradit gjatë gjithë kohës mund të jenë të pranishëm edhe anëtarët e Komisionit Zgjedhor të Qytetit të Beogradit.

9. MBYLLJA E VENDVOTIMIT

Vendvotimi, siç parashikohet në ligj, mbyllet në orën 20.00, ndërsa votuesve të cilët gjenden në vendvotim ose drejtpërdrejt para vendvotimit duhet t'u mundësohet votimi.

Këshilli i vendvotimit duhet të përcaktojë një anëtar ose zëvendësanëtar të këshillit të vendvotimit i cili do ta përcaktojë numrin e votuesve të cilët gjenden në vendvotim në kohën e mbylljes së vendvotimit dhe renditjen e votimit të tyre, si dhe të qëndrojë mbrapa votuesit të fundit të konstatuar, në mënyrë që të shënojë kështu fundin e radhës dhe të presë që të votojnë të gjithë votuesit që presin në radhë për të votuar.

Kur të kryejë votimin votuesi i fundit i hasur në vendvotim në orën 20.00 dhe kur të largohet nga vendvotimi, këshilli i vendvotimit e mbyll me çelës ambientin në të cilin është kryer votimit dhe fillon me përcaktimin e rezultateve të votimit.

Në mënyrë përjashtimore, ligji e lejon mundësinë që vendvotimi të mbyllet para orës 20.00, nëse kanë votuar të gjithë votuesit e regjistruar në ekstraktet nga lista e votuesve në këtë vendvotim. Në këtë rast, rezultatet e votimit në këtë vendvotim nuk duhet të komunikohen publikisht dhe as të theksohen diku në vendvotim para orës 20.00.

10. PËRCAKTIMI I REZULTATEVE TË VOTIMIT

Në përcaktimin e rezultateve të votimit duhet të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët e këshillit të vendvotimit ose zëvendësit e tyre.

Përcaktimi i rezultateve të votimit ka tri faza:

- plotësimi i formularit kontrollues për verifikimin e saktësisë logjiko-llogaritëse të rezultateve të votimit
- verifikimi logjiko-llogaritës të saktësisë së rezultateve të përcaktuara të votimit
- shënimi i rezultateve të votimit në Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit

! VËMENDJE:

REZULTATET E VOTIMIT NË VENDVOTIM PËRCAKTOHEN SIPAS RENDITJES NË VIJIM:

1) SË PARI përcaktohen rezultatet e votimit **për zgjedhjen e deputetëve popullorë;**

2) MË PAS përcaktohen rezultatet e votimit **për zgjedhjen e presidentit të Republikës;**

3) NË FUND përcaktohen rezultatet e votimit në **zgjedhjet lokale**, nëse këto zgjedhje janë votuar në vendvotim.

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Gjatë gjithë kohës teksa këshilli i vendvotimit është duke përcaktuar rezultatet e votimit për zgjedhjen e deputetëve popullorë, ose deri sa të plotësojë Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit për zgjedhjet parlamentare dhe deri sa të paketojë Fletën kontrolluese dhe fletëvotimet nga zgjedhjet parlamentare në zarfet përkatëse të vulosura me stikera, siç është përshkruar në pikën 10.5. të këtij manuali, **kutia e votimit me fletëvotimet për zgjedhjen e presidentit të Republikës nuk duhet të hapet por duhet të mbetet e vulosur!**

10.1. PROCEDURA E PLOTËSIMIT TË FORMULARIT KONTROLLUES PËR VERIFIKIMIN E SAKTËSISË LOGJIKO-LLOGARITËSE TË REZULTATEVE TË VOTIMIT

Formulari kontrollues për verifikimin e saktësisë logjiko-llogaritëse të rezultateve të votimit është një mjet ndihmës, i prezantuar për herë të parë në zgjedhjet për presidentin e Republikës në vitin 2017. Arsyeja e prezantimit të këtij **formulari ndihmës** është që të ndihmojë këshillat e vendvotimit në verifikimin e rezultateve të përcaktuara të votimit dhe të ulë numrin e gabimeve logjiko-llogaritëse në procesverbalet e punës së këshillave të vendvotimit.

Për zgjedhjet të cilat do të mbahen më 3 prill 2022, këshilli i vendvotimit do të marrë dy kopje të formularit kontrollues nga komisioni zgjedhor lokal: njërin për rezultatet e zgjedhjeve parlamentare dhe tjetrin për rezultatet e zgjedhjeve presidenciale.

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Këshilli i vendvotimit së pari plotëson formularin kontrollues për verifikimin e saktësisë logjiko-llogaritëse të rezultateve të votimit për zgjedhjet parlamentare, dhe më pas atë të zgjedhjeve presidenciale.

! VËMENDJE:

Formulari kontrollues **NUK MUND TA ZËVENDËSOJË PROCESVERBALIN E PUNËS SË KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT** dhe nuk është dokument zyrtar, por dokument ndihmës i cili ndihmon këshillin e vendvotimit që të verifikojë saktësinë e rezultateve të konstatuara para se të shënohen ato në procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit!

Siç është përmendur më parë te ndarja e punës në këshillin e vendvotimit, këshilli i vendvotimit duhet të përcaktojë një anëtar ose zëvendësanëtar të këshillit të vendvotimit i cili do të jetë i ngarkuar me plotësimin e formularit kontrollues dhe kryerjen e kontrollit logjiko-llogaritës të rezultateve të votimit të hedhura në formularin kontrollues.

Rezultatet të cilat këshilli i vendvotimit duhet t'i përcaktojë dhe t'i hedhë ato në Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit, janë përcaktuar në Nenin 105 të Ligjit për zgjedhjen e deputetëve popullorë.

! VËMENDJE:

Këshilli i vendvotimit nuk e hap kutinë e votimit menjëherë, por së pari bën disa veprime të cilat i paraprijnë hapjes!

SË PARI, këshilli i vendvotimit duhet të shënojë **numrin e votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve**, të cilin e ka konstatuar dhe shënuar para hapjes së vendvotimit në pikën 4 të Procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit, në rubrikën e pikës 4 të Formularit kontrollues.

SË DYTI, këshilli i vendvotimit duhet të përcaktojë **numrin e votuesve të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjet**. Ky numër përcaktohet:

- duke numëruar nënshkrimet e votuesve në ekstraktin nga lista e votuesve, në listën e ndryshimeve të mëvonshme në listën e votuesve (nëse i është dorëzuar këshillit të vendvotimit bashkë me ekstraktin) dhe në ekstraktin e veçantë nga lista e votuesve, nëse në vendvotim kanë votuar votuesit nga Ushtria e Serbisë;

- duke numëruar shënimet për votuesit të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit të cilin këshilli i vendvotimit e ka shënuar në ekstraktin nga lista e votuesve, në listën e ndryshimeve të mëvonshme në listën e votuesve (nëse i është dorëzuar këshillit të vendvotimit bashkë me ekstraktin) dhe në ekstraktin e veçantë nga lista e votuesve, nëse në vendvotim kanë votuar votuesit nga Ushtria e Serbisë.

Ky numër shënohet në rubrikën e pikës 11.1. të Formularit kontrollues.

SË TRETI, këshilli i vendvotimit duhet të përcaktojë nëse kutia e votimit ka qenë e vulosur dhe në gjendje të rregullt gjatë gjithë kohës së votimit, **DHE VETËM ATËHERË HAPET KUTIA E VOTIMIT** dhe kontrollon nëse në të gjendet edhe Fleta kontrolluese e plotësuar dhe e nënshkruar, për verifikimin e regullsisë së kutisë së votimit. Më pas, në Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit në pikën 10 duhet të rrethohet opsioni përkatës, ose të vërtetohet nëse Fleta kontrolluese është gjetur po jo, si dhe, nëse është gjetur, në pikën 10.1. të rrethohet opsioni përkatës, ose të vërtetohet se Fleta kontrolluese është nënshkruar nga ana e votuesit të parë i cili ka mbërritur në vendvotim dhe nga ana e të paktën një anëtari të këshillit të vendvotimit.

SHËNIM:

Ligji parashikon se, nëse në kutinë e votimit nuk ka fletë kontrolluese, ose fleta kontrolluese nuk është plotësuar dhe e nënshkruar nga votuesi i parë dhe të paktën njëri anëtar i këshillit të vendvotimit, komisioni zgjedhor lokal sipas detyrës zyrtare merr vendimin për anulimin e votimit në këtë vendvotim.

SË KATËRTI, numërohen të gjitha fletëvotimet në kutinë e votimit dhe ky numër shënohet në rubrikën e pikës 11.2. të Formularit kontrollues.

SË PESTI, të gjitha fletëvotimet që gjenden në kutinë e votimit, ndahen në fletëvotimet **e vlefshme dhe të pavlefshme**.

SË GJASHTI, numërohen të gjitha fletëvotimet në kutinë e votimit dhe ky numër shënohet në rubrikën e pikës 11.3. të Formularit kontrollues.

SË SHTATI, numërohen fletëvotimet e vlefshme dhe ky numër shënohet në rubrikën e pikës 11.4. të Formularit kontrollues dhe më pas, ato ndahen sipas listave zgjedhore, ose sipas kandidatëve për presidentin e Republikës.

SË TETI, numërohet numri i votave që ka marrë çdo listë ose çdo kandidat për presidentin e Republikës dhe këto numra shënohen në rubrikat përkatëse në kuadër të pikës 11.5. të Formularit kontrollues.

SHËNIM:

Kryetari i këshillit të vendvotimit është i detyruar t'i nxisë anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këshillit të vendvotimit të emëruar me propozim të listës zgjedhore të opozitës që të kontrollojnë veçanërisht disa veprime zgjedhore siç janë: kontrolli i rregullsisë së kutisë së votimit, ndarja e fletëvotimeve në ato të vlefshme dhe të pavlefshme dhe numërimi i votave të fituara nga listat zgjedhore.

! VËMENDJE:

Këshilli i vendvotimit duhet të kujdeset që Fleta kontrolluese për verifikimin e rregullsisë së kutisë së votimit të mos numërohet bashkë me fletëvotimet. **FLETA KONTROLLUESE NUK ËSHTË FLETËVOTIM!**

DALLIMI MIDIS NJË FLETËVOTIMI TË VLEFSHËM DHE TË PAVLEFSHËM ËSHTË NJË ÇËSHTJE JASHTËZAKONISHT E RËNDËSISHME!

Një fletëvotim quhet i pavlefshëm nëse:

- nuk është i plotësuar
- në të janë rrethuar numrat rendorë të dy ose më shumë listave zgjedhore, ose numrat rendor të dy ose më shumë kandidatëve për presidentin e Republikës
- është plotësuar në mënyrë të mos jetë e mundur të përcaktohet se cila listë zgjedhore ose cili kandidat për presidentin e Republikës është votuar nga votuesi

Fletëvotimi i vlefshëm quhet ai fletëvotim në të cilin është rrethuar numri rendor para emrit të njëjës liste zgjedhore ose emrit personal të kandidatit për presidentin e Republikës.

Ligji e përcakton që çdo fletëvotim i plotësuar në mënyrë që të mund të kuptohet me siguri se për kë ka votuar votuesi, quhet i vlefshëm, kështu që mund të konsiderohet i vlefshëm edhe çdo fletëvotim:

- në të cilin votuesi e ka rrethuar ose nënvizuar emrin dhe mbiemrin e kandidatit të parë në listën zgjedhore

FLETËVOTIMET PËR
ZGJEDHJEN E DEPUTETËVE
POPULLORË

1. LISTA E PARË - NOME TË KANDIDATIT
2. LISTA E DYTË - NOME TË KANDIDATIT
3. LISTA E TËRTORE - NOME TË KANDIDATIT
4. LISTA E KATËRTË - NOME TË KANDIDATIT
5. LISTA E PËNJTË - NOME TË KANDIDATIT
6. LISTA E SHËTË - NOME TË KANDIDATIT
7. LISTA E DËGJËTË - NOME TË KANDIDATIT
8. LISTA E TËRTORE - NOME TË KANDIDATIT
9. LISTA E KATËRTË - NOME TË KANDIDATIT
10. LISTA E PËNJTË - NOME TË KANDIDATIT
11. LISTA E SHËTË - NOME TË KANDIDATIT
12. LISTA E DËGJËTË - NOME TË KANDIDATIT

.....

FLETËVOTIMET PËR
ZGJEDHJEN E DEPUTETËVE
POPULLORË

1. LISTA E PARË - NOME TË KANDIDATIT
2. LISTA E DYTË - NOME TË KANDIDATIT
3. LISTA E TËRTORE - NOME TË KANDIDATIT
4. LISTA E KATËRTË - NOME TË KANDIDATIT
5. LISTA E PËNJTË - NOME TË KANDIDATIT
6. LISTA E SHËTË - NOME TË KANDIDATIT
7. LISTA E DËGJËTË - NOME TË KANDIDATIT
8. LISTA E TËRTORE - NOME TË KANDIDATIT
9. LISTA E KATËRTË - NOME TË KANDIDATIT
10. LISTA E PËNJTË - NOME TË KANDIDATIT
11. LISTA E SHËTË - NOME TË KANDIDATIT
12. LISTA E DËGJËTË - NOME TË KANDIDATIT

.....

- në të cilin votuesi e ka rrethuar ose nënvizuar emrin ose pjesën e emrit të listës zgjedhore ose emrit dhe mbiemrit të kandidatit për presidentin e Republikës



- në të cilin votuesi i ka rrethuar ose nënvizuar edhe numrin rendor para emrit të listës zgjedhore dhe emrin e kësaj liste zgjedhore dhe emrin e mbiemrin e kandidatit të parë të kësaj liste zgjedhore, ose ka nënvizuar numrin rendor para emrit dhe mbiemrit të kandidatit për presidentin e Republikës dhe emrin e propozuesit të kandidatit



- në të cilin votuesi e ka rrethuar ose nënvizuar emrin e njërit prej mbajtësve të listës zgjedhore




- në të cilin votuesi e ka rrethuar ose nënvizuar emrin dhe mbiemrin një mbajtësi të listës zgjedhore dhe emrin e mbiemrin e kandidatit të parë të kësaj liste zgjedhore




Nëse fletëvotimi është i plotësuar në mënyrë që mund të vërtetohet me siguri se për kë ka votuar votuesi, ky fletëvotim do të jetë **i vlefshëm madje edhe nëse:**

- në fletëvotim janë shkruar ose vizatuar komentet, parullat ose mesazhet e tjera



- janë zhgaravitur emrat e listave të tjera zgjedhore ose emrat dhe mbiemrat e kandidateve të tjerë për presidentin e Republikës



Pamja e formularit kontrollues për zgjedhjen e deputetëve popullorë

FORMULARI KONTROLLUES PËR KONTROLLIN E RREGULLSISË LOGJIKO-LLOGARITËSE TË REZULTATEVE TË VOTIMIT NË VENDVOTIM

РЕПУБЛИКА СРБИЈА
Републичка изборна комисија

Образац РГ-1/НП
ИЗБОРИ ЗА НАРОДНЕ ПОСЛАНИКЕ
3. април 2022. године

КОНТРОЛНИ ФОРМУЛАР

ЗА ПРОВЕРУ ЛОГИЧКО-РАЧУНСКЕ ИСПРАВНОСТИ РЕЗУЛТАТА ГЛАСАЊА НА БИРАЧКОМ МЕСТУ

ВАЖНО: Овај формулар се попуњава пре него што се резултати гласања упишу у Записник о раду бирачког одбора (Образац РГ-2/НП)

Број бирачког места: _____

Назив општине / града / завода / стране државе: _____

4.	УКУПНО БИРАЧА КОЈИ СУ УПИСАНИ У ИЗВОД ИЗ БИРАЧКОГ СПИСКА: (укључујући и евентуални списак накнадних промена у бирачком списку, као и евентуалан посебан бирачки списак за бираче у Војсци Србије ако гласају на бирачком месту)	
11.1.	БРОЈ БИРАЧА КОЈИ СУ ИЗАШЛИ НА ИЗБОРЕ: (бирачи који су се потписали у изводу из бирачког списка, евентуалном списку накнадних промена у бирачком списку и евентуалном посебном изводу из бирачког списка и напомене о бирачима који су гласали ван бирачког места у изводу из бирачког списка, евентуалном списку накнадних промена у бирачком списку и евентуалном посебном изводу из бирачког списка)	
11.2.	БРОЈ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА У ГЛАСАЧКОЈ КУТИЛИ:	
11.3.	БРОЈ НЕВАЖЕЋИХ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА:	
11.4.	БРОЈ ВАЖЕЋИХ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА:	
11.5.	БРОЈ ГЛАСОВА КОЈЕ ЈЕ ДОБИЛА СВАКА ИЗБОРНА ЛИСТА:	

Редни број	Назив изборне листе	Број гласова које је добила изборна листа
1.		
2.		
3.		
4.		
5.		
6.		
7.		
8.		
9.		
10.		
11.		
12.		

13.		
14.		
15.		
16.		
17.		
18.		
19.		
20.		
21.		

УПУТСТВО за логичко-рачунску контролу утврђених резултата гласања унетих у овај формулар

Рачунско слагање података о бирачима

Број бирача који су изашли на изборе (рубрика 11.1.) **једнак је збиру броја** бирача који су потписани у изводу из бирачког списка, у евентуалном списку наизајних промена у бирачком списку, ако је достављен уз извод из бирачког списка, и евентуалном посебном изводу из бирачког списка за гласање бирача у Војсци Србије и **броја** напомена (уместо потписа бирача) у изводу из бирачког списка и списка наизајних промена у бирачком списку о бирачима који су гласали ван бирачког места.

Укупан број бирача који су изашли на изборе (рубрика 11.1.) може бити само једнак или мањи од броја бирача уписаних у изводу из бирачког списка, списак наизајних промена у бирачком списку и у евентуалном посебном изводу из бирачког списка за гласање бирача у Војсци Србије (тачка 4.).

Рачунско слагање података о бирачима

Број гласачких листића који се налазе у гласачкој кутији (рубрика 11.2.) може бити само једнак или мањи од броја бирача који су изашли на изборе (рубрика 11.1.).

Рачунско слагање података о гласачким листићима и гласовима

Број гласачких листића који се налазе у гласачкој кутији (рубрика 11.2.) мора да буде једнак збиру: броја неважећих гласачких листића (рубрика 11.3.) и броја важећих гласачких листића (рубрика 11.4.).

Број важећих гласачких листића (рубрика 11.4.) треба да буде једнак збиру бројева гласова које су добиле све изборне листе (табела у рубрики 11.5.).

НАПОМЕНА 1: Број укупно уписаних бирача (тачка 4.) **обавезно** треба да буде уписан. Обратите пажњу на то да се приликом утврђивања укупног броја уписаних бирача узме у обзир и евентуални списак наизајних промена у бирачком списку и евентуални посебан извод из бирачког списка, ако на бирачком месту гласачу припадници Војске Србије. У случају да уз извод из бирачког списка постоји и списак наизајних промена у бирачком списку, обратите пажњу на то да ли у том списку постоје само уписи или само брисања или и уписи и брисања бирача из бирачког списка.

НАПОМЕНА 2: Контролни лист за проверу исправности гласачке кутије се **не сме убрајати** у гласачке листиће.

НАПОМЕНА 3: У случају да неки бирачки одбор запели један гласачки листић на гласачку кутију, тај гласачки листић након гласања треба да се врати међу неупотребљене гласачке листиће.

НАПОМЕНА 4: У случају да бирач који је гласао ван бирачког места није потписао потврду о изборном праву за гласање ван бирачког места или та потврда недостаје, бирачки одбор треба да гласачки листић тог бирача, који се налази у запечатеној коверти, преда локалној изборној комисији, која треба да га врати међу неупотребљене гласачке листиће.

УПУТСТВО за поступање након логичко-рачунске контроле исправности резултата унетих у овај формулар

- Ако се логичко-рачунском контролом утврди да су подаци о резултатима гласања (рубрике 11.1. до 11.5. овог формулара) **исправни**, те податке треба **ЧИТКО** преписати у Записник о раду бирачког одбора (Образац РГ-2/НП).
- Ако се логичко-рачунском контролом утврди да у подацима о резултатима **постоје грешке**, треба поново извршити логичко-рачунску контролу, па ако и даље има грешака, треба поново утврдити резултате гласања.
- Уколико се неки податак из рубрика 11.1. до 11.5. овог формулара погрешно препише у Записник о раду бирачког одбора, тај податак **НЕ ТРЕБА ПРЕПРАВЉАТИ**, већ га треба прецртати и поред њега уписати исправан. Особа која је извршила корекцију **треба да се потпише поред исправног податка**.

Најчешће формалне неправилности у Записнику о раду бирачког одбора

- Није потписала најмање три члана бирачког одбора.
- Није потпун – **недостаје нека страна**.
- Записник је **копија/фотокопија** (оба примерка записника који се предају су копија/фотокопија).
- Записник је **имао исправку** (рубрике од 11.1. до 11.5.) поред које није било потписа, како би се видело ко је исправку извршио.

Како треба да изгледа исправно попуњен и уредан Записник о раду бирачког одбора

- Све тачке и рубрике Записника треба да буду попуњене.
- Ако поједине рубрике Записника немају податке за уписивање, уписује се нула („0“) или повлака („-“).
- Записник мора бити **читко попуњен**.
- Записник **нема логичко-рачунску грешку**.
- Записник је **потписан од стране чланова бирачког одбора**.
- Записник је **потпун – има све потребне стране**.
- У општинама и градовима у којима је на дан расписивања избора у службеној употреби језик националне мањине, оригинал и копија Записника о раду бирачког одбора на свим језицима морају бити предати Изборној комисији.
- Један записник је **оригинал**, други је копија.
- Записник је **имао логичко-рачунску исправку поред које стоји потпис лица које је исправку извршило**.

АКО БИРАЧКИ ОДБОР ИМА БИЛО КАКВУ ДИЛЕМУ ОКО УТВРЂИВАЊА РЕЗУЛТАТА ИЗ ОВОГ КОНТРОЛНОГ ФОРМУЛАРА, ОБАВЕЗНО ТРЕБА ДА СЕ КОНСУЛТУЈЕ СА ИЗБОРНОМ КОМИСИЈОМ.

10.2. VERIFIKIMI LOGJIKO-LLOGARITËS TË SAKTËSISË SË REZULTATEVE TË PËRCAKTUARA TË VOTIMIT

Pasi të plotësojë Formularin kontrollues dhe të përcaktojë rezultatet e votimit në vendvotim në mënyrën e përshkruar më lart,

anëtari i ngarkuar i këshillit të vendvotimit është i detyruar të kryejë verifikimin logjiko-llogaritës të rezultateve të konstatuara të shënuara në Formularin kontrollues.

! VËMENDJE:

Këshilli i vendvotimit nuk i shënon rezultatet e votimit në Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit para se të përcaktohet paraprakisht se rezultatet e shënuara në formularin kontrollues janë të sakta. **Udhëzimi për verifikimin e saktësisë logjiko-llogaritëse të rezultateve gjendet në faqen e dytë të Formularit kontrollues.**

Kontrolli zbatohet si më poshtë:

- së pari mblidhen numrat e regjistruar të votave sipas listave zgjedhore, ose sipas kandidatëve për presidentin e Republikës (pikat në kuadër të rubrikës 11.5.) dhe ky rezultat duhet të jetë i barabartë me numrin e regjistruar të fletëvotimeve të vlefshme (rubrika 11.4)
- këtij rezultati i shtohet numri i regjistruar i fletëvotimeve të pavlefshme (rubrika 11.3.) ku duhet të rezultojë numri i fletëvotimeve të regjistruara në kutinë e votimit (rubrika 11.2.)
- numri i regjistruar i fletëvotimeve në kutinë e votimit (rubrika 11.2) mund të jetë vetëm i barabartë ose më i ulët se numri i regjistruar i votuesve të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjet (rubrika 11.1.)
- numri i regjistruar i votuesve të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjet (rubrika 11.1.) mund të jetë vetëm i barabartë ose më i ulët se numri i votuesve të regjistruar në ekstraktin nga lista e votuesve, listën e ndryshimeve të mëvonshme të listës së votuesve dhe eventualisht në ekstraktin e veçantë nga lista e votuesve për votimin e votuesve nga Ushtria e Serbisë (pika 4)

Pas verifikimit logjiko-llogaritës mund të rezultojnë dy raste:

RAST I PARË:

Nuka ka gabimëse logjiko-
llogaritëse

Të dhënat të kopjohen me kujdes në procesverbal

RASTI TJETËR:

Ka gabime logjiko-llogaritëse

Të përsëritet procedura e mbledhjes
(duke filluar nga rubrika 11.5. deri te rubrika 11.1.)

Nëse ka gabime ende

Verifikoni rezultatet përsëri

Rezultatet e votimit të kopjohen me kujdes në Procesverbalin e punës së
këshillit të vendvotimit

! VËMENDJE:

Nëse konstatohet se në rezultatet e regjistruara në Formularin kontrollues ka mospërputhje logjiko-logaritëse të disa rezultateve, këshilli i vendvotimit duhet të ri-verifikojë ato rezultate tek të cilat është konstatuar mospërputhja.

P.sh. Nuk ka dyshim se numri i regjistruar i fletëvotimeve në kutinë e votimit duhet të jetë i barabartë me shumën e regjistruar të fletëvotimeve të pavlefshme dhe të vlefshme. Prapë se prapë, nëse kjo nuk rezulton, **këshilli i vendvotimit duhet t'i numërojë fletëvotimet përsëri në mënyrë që të konstatohet se ku është bërë gabimi!**

Rrethana kur numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit është **më i ulët** se numri i votuesve të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjet tregon se ndonjë votues nuk e ka hedhur fletëvotimin në kutinë e votimit, dhe kjo njihet në ligj si parregullsi.

Megjithatë, rrethana kur numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit është **më i lartë** se numri i votuesve të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjes përbën një parregullsi të cilën ligji e përkufizon si arsye për të cilën komisioni zgjedhor lokal duhet ta anulojë votimin në vendvotim sipas detyrës zyrtare, dhe si pasojë, këshilli i vendvotimit duhet të kontrollojë se si ka ndodhur kjo situatë dhe nëse gabimi është bërë gjatë numërimit.

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Duhet të kemi parasysh se disa gabime në rezultatet e përcaktuara të votimit mund të jenë pasojë si e gabimit në numërim, ashtu edhe të keqpërdorimeve të mundshme, si p.sh. hedhja e qëllimshme e fletëvotimeve në kutinë e votimit në mënyrë që numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit të jetë më i lartë se numri i votuesve të evidentuar në ekstrakt si votues të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjet. Më tej, kjo nënkupton që këshilli i vendvotimit nuk mund të përshtatë rezultatet e votimit me çdo kusht për t'i përshtatur ato në mënyrë të logjikshme, por duhet të konstatojë gjendjen e faktit dhe gabimin eventual.

10.3. SHËNIMI I REZULTATEVE TË VOTIMIT NË PROCESVERBALIN E PUNËS SË KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT

Vetëm pasi të konstatohet se pas verifikimit logjiko-llogaritës rezultatet e regjistruara të votimit në Formularin kontrollues janë të sakta nga ana logjiko-llogaritëse, ose pasi të përcaktohet përfundimisht se rezultatet e konstatuara të votimit janë në përputhje me gjendjen e materialit zgjedhor, këshilli i vendvotimit fillon me plotësimin e Procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit (në tekstin e mëtejshëm: Procesverbal).

! VËMENDJE:

Në komuna/qytete në të cilat përdoret zyrtarisht ndonjë gjuhë e pakicave kombëtare, përveç Procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit i cili është hartuar në gjuhën serbë me shkrimin cirilik, plotësohet dhe Procesverbali i përpiluar në gjuhën e kësaj pakice kombëtare!

Nëse në komunë/qytet janë në përdorimin zyrtar gjuhët e disa pakicave kombëtare, përpilohen ose plotësohen procesverbalet e posaçëm në secilën prej këtyre gjuhëve!

Fillimisht, këshilli i vendvotimit duhet të kontrollojë nëse është plotësuar Kreu I i Procesverbalit (pikat 1, 2, 3 dhe 4) dhe tri pikat e para në kuadër të Kreut II (Pikët 5, 6 dhe 7), dhe më pas fillon me plotësimin e pikave të tjera në kuadër të Kreut II dhe IV të Procesverbalit (pikat 12, 12, 13, 13.1 dhe 14.1) duke shënuar në Procesverbal NË MËNYRË TË LEXUESHME:

1) nëse ka pasur ndërprerje të votimit në vendvotim (duke rrethuar fjalën "PO" ose "JO") dhe nëse ka pasur ndërprerje, duhet shënuar kohëzgjatja dhe arsyeja e ndërprerjes - pikat 8, 8.1 dhe 8.2 të Procesverbalit.

2) koha e mbylljes së vendvotimit - pika 9 e Procesverbalit.

! VËMENDJE:

Koha e mbylljes së vendvotimit është koha në të cilën ka përfunduar votimi, ndryshe nga koha në të cilën këshilli i vendvotimit ka përfunduar punën e tij dhe kjo kohë shënohet në fund të Procesverbalit, duke pasur parasysh se pas përfundimit të votimit fillon puna e këshillit të vendvotimit për përcaktimin e rezultateve të votimit.

3) nëse në kutinë e votimit është gjetur Fleta kontrolluese (duke rrethuar fjalën “PO” ose “JO”) dhe nëse është gjetur, a është e nënshkruar nga ana e votuesit të parë në vendvotim dhe të paktën një anëtar i të këshillit të vendvotimit - pikat 10 dhe 10.1 të Procesverbalit.

4) numri i votuesve të cilët kanë votuar me ndihmën e një personi tjetër (ndihmësit) - pika 12 e Procesverbalit.

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Të dhënat për votimin me ndihmën e ndihmësit duhet të përfshijnë si votimin në vendvotim ashtu edhe votimin jashtë vendvotimit.

5) numri i votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit – pika 13 e Procesverbalit.

6) numri i vërtetimeve të plotësuara dhe të nënshkruara për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit – pika 13 e 1. Procesverbalit.

7) nëse ishin të pranishëm në vendvotim përfaqësuesit e vëzhguesve vendas dhe/ose të huaj dhe nëse po, a është plotësuar formulari i Procesverbalit për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit (duke rrethuar fjalën “PO” ose “JO”) - pikat 14 dhe 14.1 të Procesverbalit

SHËNIM I RËNDËSISHËM:

Procesverbali për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit është unik edhe për zgjedhjet për deputetët popullorë edhe për zgjedhjet për presidentin e Republikës, kështu që nuk përpilohet një procesverbal i posaçëm për vëzhguesit për zgjedhjen e deputetëve popullorë dhe një tjetër i posaçëm për vëzhguesit për zgjedhjen e presidentit të Republikës. Prandaj në dy Procesverbalet për punën e këshillit të vendvotimit konstatohet se është plotësuar Procesverbali unik për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit.

Pas regjistrimit të të dhënave të lartpërmendura, në procesverbalin **kopjohen në mënyrë të lexueshme** rezultatet e votimit nga Formulari kontrollues në Kreun III të Procesverbalit.

1) numri i votuesve të cilët kanë marrë pjesë në zgjedhjet – pika 11.1 e Procesverbalit.

2) numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit - pika 11.2 e Procesverbalit.

3) Numri i fletëvotimeve të pavlefshme - pika 11.3 e Procesverbalit.

4) Numri i fletëvotimeve të vlefshme - pika 11.4 e Procesverbalit.

5) Numri i votave për çdo listë zgjedhore ose numri i votave për çdo kandidat për presidentin e Republikës - pika 11.5 e Procesverbalit.

SHËNIM:

Te regjistrimi i rezultateve të votimit, asnjë rubrikë nuk duhet të mbetet e paplotësuar. Kjo do të thotë se p.sh. nëse ndonjë listë zgjedhore ose kandidat për presidentin e Republikës nuk kanë marrë asnjë votë në vendvotim, rubrika e cila i referohet numrit të votave për këtë listë zgjedhore ose kandidat për presidentin e Republikës nuk duhet të mbetet e paplotësuar, por në të duhet të shënohet ose zero ("0") ose vizë ("-").

Pas plotësimit të rezultateve të votimit, fillon plotësimi i pikës 15 të Procesverbalit, e cila i referohet ankesave nga anëtarët e këshillit të vendvotimit ndaj procedurës së zbatimit të votimit në vendvotim (duke rrethuar fjalën "PO" ose "JO").

Nëse në pikën 15 është rrethuar fjala "PO", ose nëse anëtarët e këshillit të vendvotimit kanë pasur ankesa, duhet t'i shkruajnë ato në një shtojcë e cila do të jetë pjesë përbërëse e procesverbalit dhe do t'i dorëzohet komisionit zgjedhor lokal së bashku me procesverbalin.

Plotësimi i rregullt i pjesës së Procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit me rezultatet e votimit në vendvotim

III. REZULTATI GLASAŊA		
11.1.	БРОЈ БИРАЧА КОЈИ СУ ИЗАШЛИ НА ИЗБОРЕ: (бирачи који су се потписали и напомене у изводу из бирачког списка, евентуалном списку накнадних промена у бирачком списку и евентуалном посебном изводу из бирачког списка о бирачима који су гласали ван бирачког места)	105
11.2.	БРОЈ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА У ГЛАСАЧКОЈ КУТИЈИ:	105
11.3.	БРОЈ НЕВАЖЕЋИХ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА:	5
11.4.	БРОЈ ВАЖЕЋИХ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА:	100
11.5.	БРОЈ ГЛАСОВА КОЈЕ ЈЕ ДОБИЛА СВАКА ИЗБОРНА ЛИСТА	
<i>Редни број</i>	<i>Назив изборне листе</i>	<i>Број гласова које је добила изборна листа</i>
1.	АААА	20
2.	ББББ	0
3.	ЦЦЦЦ	35
4.	ДДДД	5
5.	ГГГГ	0
6.	ЕЕЕЕ	15
7.	ФФФФ	25
	(Навести све изборне листе, према њиховом редоследу на гласачком листићу)	

! VËMENDJE:

Nëse ndonjë informacion shënohet në procesverbal në mënyrë të gabuar, ai nuk duhet të korrigohet, por gabimi korrigohet duke e shlyer informacionin e gabuar dhe duke shënuar informacionin e saktë pranë tij, me nënshkrimin e personit i cili ka bërë korrigjimin

Korrigjimi i saktë i gabimit në Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit

III. РЕЗУЛТАТИ ГЛАСАЊА		
11.1.	БРОЈ БИРАЧА КОЈИ СУ ИЗАШЛИ НА ИЗБОРЕ: (бирачи који су се потписали и напомене у изводу из бирачког списка, евентуалном списку накнадних промена у бирачком списку и евентуалном посебном изводу из бирачког списка о бирачима који су гласали ван бирачког места)	105
11.2.	БРОЈ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА У ГЛАСАЧКОЈ КУТИЈИ:	105
11.3.	БРОЈ НЕВАЖЕЋИХ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА:	5
11.4.	БРОЈ ВАЖЕЋИХ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА:	25100
11.5.	БРОЈ ГЛАСОВА КОЈЕ ЈЕ ДОБИЛА СВАКА ИЗБОРНА ЛИСТА	
<i>Редни број</i>	<i>Назив изборне листе</i>	<i>Број гласова које је добила изборна листа</i>
1.	АААА	20
2.	ББББ	0
3.	ЦЦЦЦ	30 35
4.	ДДДД	5
5.	ГГГГ	0
6.	ЕЕЕЕ	15
7.	ФФФФ	25
(Навести све изборне листе, према њиховом редоследу на гласачком листићу)		

Korrigjimi i pasaktë i gabimit në Procesverbalin e punës së këshillit të vendvotimit

III. РЕЗУЛТАТИ ГЛАСАЊА		
11.1.	БРОЈ БИРАЧА КОЈИ СУ ИЗАШЛИ НА ИЗБОРЕ: (бирачи који су се потписали и напомене у изводу из бирачког списка, евентуалном списку накнадних промена у бирачком списку и евентуалном посебном изводу из бирачког списка о бирачима који су гласали ван бирачког места)	105
11.2.	БРОЈ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА У ГЛАСАЧКОЈ КУТИЈИ:	105
11.3.	БРОЈ НЕВАЖЕЋИХ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА:	5
11.4.	БРОЈ ВАЖЕЋИХ ГЛАСАЧКИХ ЛИСТИЋА:	100
11.5.	БРОЈ ГЛАСОВА КОЈЕ ЈЕ ДОБИЛА СВАКА ИЗБОРНА ЛИСТА	
<i>Редни број</i>	<i>Назив изборне листе</i>	<i>Број гласова које је добила изборна листа</i>
1.	АААА	20
2.	ББББ	0
3.	ЦЦЦЦ	35
4.	ДДДД	5
5.	ГГГГ	0
6.	ЕЕЕЕ	15
7.	ФФФФ	25
(Навести све изборне листе, према њиховом редоследу на гласачком листићу)		

Нë fund, нë процесвербалн шëноhet data dhe koha e пërfundimit тë пунëс сë кëшиллит тë vendvotimit, ose тë plotësimит тë процесвербалит.

Procesverbali i plotësuar nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e këshillit të vendvotimit ose zëvendësit e anëtarëve të munguar, që është **detyrimi ligjor** i tyre.

Procesverbali përpilohet në gjashtë kopje identike (në letrën vetë-kopjuese).

Kopja e pare origjinale e procesverbalit i dorëzohet DETYRIMISHT komisionit zgjedhor lokal, i cili ia dorëzon KQZ-së.

Kopja e dytë i dorëzohet gjithashtu komisionit zgjedhor lokal.

Kopja e tretë shpallet në vendvotim, për qasje publike.

Tri kopje të tjera u dorëzohen anëtarëve ose zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit të emëruar me propozim të paraqitësve të listave zgjedhore, ose me propozim të propozuesit të kandidatit për presidentin e Republikës të cilët kanë fituar numrin më të lartë të votave në vendvotim.

Kopjet eventualisht e padorëzuara të Procesverbalit i dorëzohen komisionit zgjedhor lokal nga këshilli i vendvotimit, së bashku me materialet e tjera zgjedhore.

10.4. PLOTËSIMI I PROCESVERBALIT PËR VËZHguesIT E PUNËS SË KËSHILLIT TË VENDVOTIMIT

Ligji i ri për zgjedhjen e deputetëve popullorë prezantoi një dokument të ri zgjedhor i cili përpilohet nga këshilli i vendvotimit - Procesverbali për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit, i cili hartohet në formularin e përcaktuar nga KQZ.

Procesverbali për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit plotësohet gjatë gjithë ditës, në varësi nga fakti nëse në vendvotim është paraqitur përfaqësuesi i vëzhguesit vendas ose të huaj.

Kjo praktikisht do të thotë se këshilli i vendvotimit duhet të evidentojë përfaqësuesin e vëzhguesit në Procesverbalin për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit, menjëherë pas mbërritjes së tij në vendvotim, dhe t'i mundësojë atij që të regjistrojë vet në procesverbal të gjitha vërejtjet ose ankesat në lidhje me zbatimin e votimit në vendvotim.

Këshillohet që të kujdeseni që këshilli i vendvotimit të shënojë në Procesverbalin:

- emrat dhe mbiemrat e të gjithë përfaqësuesve të pranishëm në vendvotim;

- emrat e vëzhguesit vendas ose të huaj të cilët kanë ndjekur punën e këshillit të vendvotimit;

- nëse përfaqësuesit e vëzhguesve kanë patur ankesa ndaj procedurës së zbatimit të votimit;

- kohën e largimit të përfaqësuesit të vëzhguesit nga vendvotimi.

SHËNIM:

Përfaqësuesi i vëzhguesit ka të drejtë t'i shënojë vet vërejtjet dhe ankesat e tij në Procesverbal!

! VËMENDJE:

Ju kujtojmë se përfaqësuesit e vëzhguesve mund të vijnë në vendvotim gjatë mbledhjes së anëtarëve të këshillit të vendvotimit, pra edhe para hapjes së vendvotimit, dhe mund të rrinë në vendvotim deri në fund të punës së këshillit të vendvotimit, duke përfshirë edhe vëzhgimin e punës së këshillit të vendvotimit gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor pranë komisionit zgjedhor lokal pas votimit në ndërtesën e komunës/qytetit.

Nuk duhet të harrohet që përfaqësuesi i vëzhguesit i cili ka shënuar vërejtjet në Procesverbalin e vëzhguesve, duhet të nënshkruhet në rubrikën përkatëse të Procesverbalit.

Procesverbali i vëzhguesve përpilohet në gjashtë kopje identike, nga të cilat e para (originali) dhe e dyta paraqiten bashkëngjitur kopjes së parë (originalit) ose kopjes së dytë të Procesverbalit për punën e këshillit të vendvotimit në zbatimin e votimit në zgjedhjet për deputetët popullorë, ndërsa katër kopje të tjera u dorëzohen përfaqësuesve të vëzhguesve të pranishëm gjatë përfundimit të punës së këshillit të vendvotimit

10.5. PAKETIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR

Pasi përfundon me plotësimin e Procesverbalit, këshilli i vendvotimit duhet të paketojë në zarfe të veçanta:

- Fletën kontrolluese për verifikimin e regullsisë së kutisë së votimit
- fletëvotimet e papërdorura
- fletëvotimet e vlefshme
- fletëvotimet e pavlefshme
- vërtetimet për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit (të nënshkruara dhe të panënshkruara)

Mbi të gjitha zarfet detyrimisht duhet të shkruhet përmbajtja e zarfit, emri i zgjedhjeve, emri i komunës/qytetit dhe numri i vendvotimit.

Zarfet duhet të jenë të vulosura me stiker.

Pasi të kryejë paketimin e materialit zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare në zarfe, ose në shirita, këshilli i vendvotimit kalon te përcaktimi i rezultateve të votimit për zgjedhjen e presidentit të Republikës dhe me këtë qëllim ndërmerr të gjitha veprimet e përshkruara paraprakisht, duke përfshirë paketimin e materialit zgjedhor.

Pasi të kryejë paketimin e materialit zgjedhor të zgjedhjeve presidenciale në zarfe, këshilli i vendvotimit kalon te paketimi i materialit zgjedhor të të dy zgjedhjeve në thasë përkatës, njësoj siç janë sjellë materialet në vendvotim (thesi **gri** do të përdoret për zgjedhjet parlamentare, ndërsa thesi **i kaltër** do të përdoret për zgjedhjet presidenciale), duke u kujdesur që thesi të mbetet i shënuar me stiker.

! VËMENDJE:

Këshilli i vendvotimit duhet të kujdeset që mos të përziej materialin zgjedhor i zgjedhjeve të ndryshme dhe që materiali zgjedhor të paktohet në thesin përkatës.

Këshilli i vendvotimit duhet të kujdeset që sprejat për shënimin e gishtit të votuesit, llambat UV dhe të gjitha materialet e zyrës, duke përfshirë edhe gërshërët, të vihen në një qese të veçantë ose në një thes të vogël në të cilën kanë qenë të paketuara gjatë dorëzimit

para votimit dhe të vendosen kështu **në thesin me materialin zgjedhor të zgjedhjeve parlamentare** Qesja, ose thesi i vogël duhet të jetë i mbyllur/lidhur, në mënyrë që përmbajtja të mos përzihet me materialin në thes.

SHPALLJA E PROCESVERBALIT PËR QASJE PUBLIKE

Pasi të kryhet puna në përcaktimin e rezultateve të votimit në të gjitha zgjedhjet që janë votuar në vendvotim dhe pasi të plotësohen të gjitha procesverbalet e punës së këshillit të vendvotimit dhe të pakëtohet materiali zgjedhor në thasët përkatës, këshilli i vendvotimit i shpall **kopjet e treta** të të gjitha procesverbaleve të punës së këshillit të vendvotimit në vendvotim, për qasje publike.

MBAJTJA E NJËKOHSHME E ZGJEDHJEVE LOKALE DHE ZGJEDHJEVE PARLAMENTARE

Në rast të mbajtjes së njëkohshme edhe të zgjedhjeve lokale, këshilli i vendvotimit duhet të fillojë me përcaktimin e rezultateve të votimit në zgjedhjet lokale vetëm pasi të përcaktohen rezultatet e votimit në zgjedhjet parlamentare.

! VËMENDJE:

Ligji parashikon që materiali zgjedhor i dorëzohet komisionit zgjedhor lokal nga kryetari i këshillit të vendvotimit ose zëvendësi i tij, dhe se të gjithë anëtarët e këshillit të vendvotimit mund të jenë të pranishëm gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor.

Duke marrë parasysh se njëkohësisht do të mbahen zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale më 3 prill 2022, gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor është e nevojshme që, përveç kryetarit të këshillit të vendvotimit dhe zëvendësit të tij, të jenë të pranishëm edhe anëtarët e tjerë të këshillit të vendvotimit të cilët do të ndihmojnë në dorëzimin e materialit zgjedhor pranë komisionit zgjedhor lokal.

11. DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR PAS VOTIMIT

Materiali zgjedhor për të dy proceset zgjedhore i dorëzohet pas votimit komisionit zgjedhor lokal në selinë e komunës/qytetit. Gjatë dorëzimit mund të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët dhe zëvendësanëtarët e këshillit të vendvotimit.

Materiali zgjedhor i dorëzohet komisionit zgjedhor lokal pa vonesë në përputhje me Ligjin, dhe **jo më vonë se 12 orë pas mbylljes së vendvotimit.**

Për çdo proces zgjedhor përpilohet një procesverbal i veçantë për dorëzimin e materialit.

SHËNIM:

Gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor dhe pas votimit mund të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e paraqitësve të listave zgjedhore, ose të propozuesve të kandidatit për presidentin e Republikës, si dhe përfaqësuesit e vëzhguesve të akredituar nga KQZ.

Komisionit zgjedhor lokal i dorëzohen veç e veç për zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale:

- kopja e pare (originali) dhe kopja e dytë e Procesverbalit të punës së këshillit të vendvotimit në gjuhën serbe dhe me shkrim cirilik dhe në çdo gjuhë dhe shkrim të pakicave kombëtare në përdorimin zyrtar në atë njësi të vetëqeverisjes lokale
- kopja e parë (originali) dhe e dytë të procesverbalit për vëzhguesit e punës së këshillit të vendvotimit
- ekstrakti nga lista e votuesve sipas së cilës është bërë votimi në vendvotim
- ekstrakti i veçantë nga lista e votuesve, nëse në vendvotim kanë votuar edhe votuesit të cilët janë duke bërë shërbimin ushtarak, ushtrim ushtarak ose shkollim në njësitë ose institucionet e Ushtrisë së Serbisë
- zarfi në të cilin gjendet Fleta kontrolluese për verifikimin e rregullsisë së kutisë së votimit i vulosur me stiker
- zarfi me fletëvotimet e papërdorura i vulosur me stiker ose shirit

- zarfi me fletëvotimet e pavlefshme i vulosur me stiker ose shirit
- zarfi me fletëvotimet e vlefshme i vulosur me stiker ose shirit
- zarfi me vërtetimet për të drejtën zgjedhore të votuesve të cilët kanë votuar jashtë vendvotimit i vulosur me stiker
- blloba e sigurisë e përdorur për vulosjen e thesit me materialin zgjedhor gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor midis komisionit zgjedhor lokal dhe këshillit të vendvotimit para votimit
- Nga një kopje e evidencës së pranisë në vendvotim të anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar

Pas dorëzimit të materialit zgjedhor pranë komisionit zgjedhor lokal, **këshilli i vendvotimit ia dorëzon administratës së komunës/qytetit** materialet e tjera zgjedhore:

- dy kuti votimi
- sprejat për shënimin e gishtave të votuesve
- llambat UV
- paravanet e votimit
- nga një kopje e evidencës së pranisë në vendvotim të anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar
- Kapëset për kartat e identifikimit të anëtarëve të këshillit të vendvotimit
- pajisje shkrimi, gërshërët etj.

VULOSJA E THESIT ME MATERIALIN ZGJEDHOR

Pasi të kryhet dorëzimi i materialit zgjedhor të përmendur më lartë (për të dy proceset zgjedhore), thasët në të cilët janë vendosur materialet zgjedhore, të cilat janë parashikuar të vihen në thasë, **vulosen nga komisioni zgjedhor lokal me blloba sigurie (blloba e bardhë për zgjedhjet parlamentare dhe e kaltra për ato presidenciale)**, numrat serial e të cilave shënohen në procesverbalin e dorëzimit të materialit zgjedhor për zgjedhjet parlamentare dhe në

procesverbalin e dorëzimit të materialit zgjedhor për zgjedhjet presidenciale.

Në thasë vihet edhe bllomba e sigurisë me të cilën ishte vulosur thesi përkatës gjatë dorëzimit të materialit zgjedhor para votimit.

Gjatë vulosjes së thasëve duhet të jenë të pranishëm anëtarët e këshillit të vendvotimit të cilët e kanë dorëzuar materialin.

! VËMENDJE:


Në thes **kurrsesi nuk vihen** materialet zgjedhore në vijim:

- Procesverbali i punës së këshillit të vendvotimit
- Procesverbali i vëzhguesve të punës së këshillit të vendvotimit
- ekstrakti nga lista e votuesve, me listën eventuale të ndryshimeve të mëvonshme dhe ekstrakti i veçantë nga lista e votuesve për votim të votuesve në Ushtrinë e Serbisë
- zarfi me vërtetimet për të drejtën zgjedhore për votim jashtë vendvotimit
- kopja e procesverbalit për dorëzimin e materialit zgjedhor pas votimit midis këshillit të vendvotimit dhe komisionit zgjedhor lokal
- nga një kopje e evidencës së pranisë në vendvotim të anëtarëve dhe zëvendësanëtarëve të këshillit të vendvotimit në përbërje të përhershme dhe të zgjeruar

Materialet zgjedhore të mësipërme vendosen veçmas nga materiali zgjedhor i cili vihet në thes.

SHËNIM:

Në praktikë mund të ndodhin situata që të mos ketë stiker mbi thes i cili ishte i ngjitur gjatë dorëzimit të materialit para votimit. Në këtë rast, **para vulosjes**, komisioni zgjedhor lokal duhet të shkruajë me marker mbi thes, emrin e zgjedhjeve, numrin e vendvotimit dhe emrin e komunës/qytetit.



DORËZIMI I MATERIALIT ZGJEDHOR PËR VOTIM JASHTË VENDIT

Njësoj si në rastin e dorëzimit të materialit zgjedhor këshillave të vendvotimit në vendvotime jashtë vendit para votimit, rregullat e veçanta për këto këshilla të vendvotimi janë parashikuar edhe në lidhje me **dorëzimin e materialit zgjedhor pas votimit**. Këshillat e vendvotimit nga vendvotimet jashtë vendit nuk ia dorëzojnë materialin zgjedhor komisionit zgjedhor lokal, por drejtpërsëdrejti koordinatorit të KQZ-së.

Dorëzimi kryhet në Beograd, në selinë e KQZ-së. Për çdo proces zgjedhor përpilohet nga një **procesverbal i veçantë** për dorëzimin.

Këshilli i vendvotimit e transporton materialin zgjedhor nga vendvotimi jashtë vendit ashtu siç dërgohen dërgesat diplomatike, duke e mundur kështu sigurinë e materialit zgjedhor.

MBAJTJA E NJËKOHSHME E ZGJEDHJEVE LOKALE DHE PARLAMENTARE

Nëse në vendvotim u votuan edhe zgjedhjet lokale, këshilli i vendvotimit si dhe komisioni zgjedhor lokal duhet të kujdesen që të mos përzihet materiali zgjedhor i zgjedhjeve parlamentare me atë të zgjedhjeve lokale.

12. VEPRAT PENALE KUNDËR TË DREJTAVE ZGJEDHORE

Kreu Pesëmbëdhjetë të Kodit Penal përcakton veprat penale kundër të drejtave zgjedhore. Në kuadër të kësaj pjesë të Udhëzuesit, do t'i njohim anëtarët e këshillave të vendvotimeve me këto vepra penale si dhe me dënimet e parashikuara.

Cenimi i të drejtave të votimit

Neni 155

(1) Kushdo që në mënyrë të kundërligjshme dhe me qëllim të pengimit të personit tjetër nga ushtrimi i së drejtës së tij për të

votuar, nuk e regjistron personin e tillë në listën e votuesve ose e heq personin e tillë nga lista e votuesve, ose e pengon në ndonjë mënyrë tjetër, do të dënohet me gjobë ose burgim deri në një (1) vit.

(2) Kushdo që me përdorimin e forcës ose kanosjes e detyron personin tjetër që në zgjedhjet, votimin për revokim ose në referendum të ushtrojë ose të mos ushtrojë të drejtën për të votuar ose që të votojë për ose kundër kandidatit ose propozimit të caktuar, do të dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 3 vjet.

Dhënia dhe marrja e ryshfetit në lidhje me votimin

Neni 156

(1) Kushdo që i ofron, jep ose premtion një shpërblim, dhuratë ose përfitim tjetër një personi, në shkëmbim të votimit ose mosvotimit në zgjedhjet ose referendum në dobi ose kundër ndonjë personi ose propozimi të caktuar, do të dënohet me gjobë ose burgim deri në 3 vjet.

(2) Me dënimin nga paragrafi 1 i këtij Neni do të dënohet kushdo që kërkon ose pranon dhuratën ose cilindo përfitim tjetër për të votuar ose për të mos votuar në zgjedhjet ose referendum, në dobi ose kundër personit të caktuar ose propozimit.

(3) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij Neni kryhet nga anëtari i këshillit të vendvotimit ose një person tjetër në kryerjen e detyrës së lidhur me votimin, do të dënohet me burgim nga 3 muaj deri në 5 vjet.

(4) Dhurata dhe përfitimet e tjera do të sekuestrohen.

Keqpërdorimi i të drejtave të votimit

Neni 157

(1) Kushdo që voton në zgjedhje ose referendum në vend të personit tjetër, me emrin dhe mbiemrin e këtij personi ose voton më shumë se një herë në të njëjtin votim ose përdor më shumë se një fletëvotim, do të dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

(2) Anëtari i këshillit të vendvotimit i cili i mundëson personit tjetër që të kryejë veprën nga paragrafi 1 i këtij Neni, do të dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

Parandalimi i mbajtjes së votimit

Neni 159

(1) Kushdo që përdor forcën, kanosjen ose ndonjë mënyrë tjetër të kundërligjshme për të parandaluar votimin në vendvotim, do të dënohet me burgim deri në 3 vjet.

(2) Kushdo që nxit prishjen e rendit publik në vendvotim, që rezulton me ndërprerje në procesin e votimit, do të dënohet me gjobë ose burgim deri në dy vjet.

Cenimi i fshehtësisë së votimit

Neni 160

(1) Kushdo që në zgjedhje ose në referendum cenon fshehtësinë e votimit, dënohet me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij Neni kryhet nga anëtari i këshillit të vendvotimit ose një person tjetër në kryerjen e detyrës së lidhur me votimin, do të dënohet me gjobë ose burgim deri në 2 vjet.

Falsifikimi i rezultateve të votimit

Neni 161

Anëtari i organit të zbatimit të zgjedhjeve ose referendumit ose një person tjetër në kryerjen e detyrave të lidhura me votimin, i cili ndryshon numrin e fletëvotimeve ose votave duke shtuar ose hequr fletëvotimet ose votat gjatë numërimit, ose ndryshon numrin e

fletëvotimeve ose votave në ndonjë mënyrë tjetër ose publikon rezultatet e pavërteta të votimit, do të dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Asgjësimi i dokumenteve të votimit

Neni 162

(1) Kushdo që asgjëson, dëmton, merr apo fsheh fletëvotimin ose ndonjë tjetër dokument lidhur me zgjedhjet ose referendumin, do të dënohet me gjobë ose burgim deri në një vit.

(2) Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij Neni kryhet nga anëtari i këshillit të vendvotimit ose një person tjetër në kryerjen e detyrës së lidhur me votimin, do të dënohet me burgim nga 3 muaj deri në tre vjet.